



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 827/prot.

Tiranë, më 15.02. 2024

Lënda: Dërgohet urdhër për njohje dhe zbatim

UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza"

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 144/5 prot., datë 09.02.2024, protokolluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me nr. 827/1 prot, datë 12.02.2024, bashkëlidhur ju dërgojmë për njohje dhe zbatim urdhrin nr. 71, datë 15.02.2024 "Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Universitetit të Arteve".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 827/13 Prot.

Tiranë, më 15.02. 2024

URDHËR

Nr. 71, datë 15.02. 2024

PËR
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË
ARTEVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe shkronjës “gj” të pikës 2 të urdhrit nr. 566, datë 5.10.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Albana Tole”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve, të miratuar me urdhrin nr. 319, datë 13.9.2021, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e statutit të Universitetit të Arteve”, sipas propozimeve të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 27/2 datë 06.2.2024 dhe të vendimit nr. 27/2 datë 07.02.2024 të Senatit Akademik.
2. Ndryshimet në statutin e Universitetit të Arteve, miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
3. Ndryshimet e statutit të Universitetit të Arteve, hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti i Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

Albana Tole


ALBANA TOLE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

STATUTI
I
UNIVERSITETIT TË ARTEVE



MIRATUAR
ME VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK
NR. 15, DATË 30/08/2021

(Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 27/2 datë 07/02/2024)



Parathënie

Universiteti i Arteve si institucioni i parë dhe i vetëm i fushave të arteve, përfshin në trashëgiminë e vet të vyer, eksperiencën e shkëlqyer të Konservatorit të Muzikës të krijuar në vitin 1962, Institutit të Arteve të Bukura të krijuar në vitin 1959, Shkollës së Teatrit të krijuar në vitin 1959 dhe së bashku krijuan Institutit të Lartë të Arteve të krijuar në vitin 1966 dhe më pas u riemërua Akademia e Arteve në vitin 1991, sot Universiteti i Arteve.


Universiteti i Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve, është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 234, datë 23.03.2011.

Universiteti i Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve gëzon status të veçantë në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, *“Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”*.

Universiteti i Arteve përmbledh një tërësi vlerash artistike, kulturore, akademike dhe shoqërore, të krijuara dhe formësuara prej një kohe të gjatë e prej një mori brezash të njëpasnjëshëm të pedagogëve, studentëve, artistëve e personaliteteve nga më të shquarat në Shqipëri.

Universiteti i Arteve është nxitës dhe nismëtar i zhvillimeve artistike e kulturore në Shqipëri dhe në gjithë hapësirat e banuara nga shqiptarët por edhe më gjerë, për të përmbushur ruajtjen, mbrojtjen dhe pasurimin e trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, me qëllim rritjen e kontributit tonë për shtimin e vlerave kulturore në hapësirat gjeografike e politike evropiane e botërore.

Universiteti i Arteve është vlerësuar dhe ka zënë një vend të denjë ndër institucionet arsimore artistike e shkencore në vend.



KREU I PARË DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i Statutit

Ky statut ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Arteve, strukturave përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe të organeve drejtuese, zgjedhjen apo emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e Universitetit të Arteve.

Neni 2 Baza ligjore

Ky statut bazohet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, në aktet nënligjore në zbatim të tij, në legjislacionin në fuqi si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3 Personaliteti Juridik

1. Universiteti i Arteve është person juridik publik, i regjistruar rregullisht dhe i njohur me ligj si i tillë.
2. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe me rregullat e parashikuara në këtë Statut dhe në Rregulloret e tij.
3. Gëzojnë personalitet juridik edhe njësitë përbërëse sipas kufijve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky Statut.

Neni 4 Misioni

Universiteti i Arteve si një institucion publik i arsimit të lartë ka për mision:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik/shkencor;
- b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit;
- c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfitur nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik/shkencor;
- g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë;
- h) të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;
- i) të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës;
- j) të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar



- e tejçuar artin e kulturën;
- k) të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit;
 - l) të krijojë gjithë përfshirjen e studentëve vendas dhe të huaj shqipfolës;
 - m) të garantojë shprehjen e lirë në programet e tij mësimore të ideve kulturore, artistike dhe shkencore, politike, sindikale e fetare, që janë me karakter artistik, shkencor.

Neni 5 Akronime

Në këtë statut termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "UART" është akronimi i emrit të Universitetit të Arteve Tiranë.
- b) "FM" është akronimi i emrit të Fakultetit të Muzikës.
- c) "FAS" është akronimi i emrit të Fakultetit i Artit Skenik.
- d) "FAB" është akronimi i emrit të Fakultetit i Arteve të Bukura.
- e) "SA" është akronimi i emrit të Senatit Akademik.
- f) "BA" është akronimi i emrit të Bordit të Administrimit.

Neni 6 Liria akademike, autonomia financiare dhe organizative

1. UART gëzon liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Liria akademike garantohehet nëpërmjet së drejtës:
 - a) për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-artistike dhe shkencore e të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese, në përputhje me misionin dhe qëllimet e tij;
 - b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore;
 - c) garanton zhvillimin e karrierës së personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, meritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Mundëson kualifikimin e vazhdueshëm të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ.
3. Autonomia financiare garantohehet nëpërmjet së drejtës:
 - a) për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga shërbimet si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;
 - c) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe të përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të universitetit;
 - d) për të përcaktuar tarifatat e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - e) për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të tij;
 - f) për të krijuar, në përputhje me dinamikën e zhvillimit, institute, qendra, njësi shërbimi, njësi trajnimi etj., që gjenerojnë të ardhura, me statuse të ndryshme, në nivelin e njërive bazë, të njërive kryesore apo në nivel universiteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohehet nëpërmjet së drejtës:
 - a) për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe për të rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme të institucionit;
 - b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me përcaktimet ligjore;
 - c) për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, artistike-kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera të ligjshme;

- d) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - e) për të vendosur marrëdhënie me institucione e organizata vendase apo të huaja, publike e jo publike, me organizata biznesi, OJF etj., lidhur me bashkëpunimin institucional, artistik, profesional e shkencor, për shkëmbimin e përvojave, të personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, për praktikat e studenteve, projekte të përbashkëta etj.
5. Roli i organeve dhe strukturave shtetërore, përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre janë si më poshtë:
- a) garantojnë autonominë dhe lirinë akademike;
 - b) vlerësojnë cilësinë dhe funksionimin e UART, përmes agjencive të pavarura shqiptare ose të huaja, duke bërë publik procesin dhe rezultatet e tij;
 - c) vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit artistik dhe shkencor;
 - d) vë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në UART, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve;
 - e) garantojnë paprekshmërinë e UART dhe të territorit të tij. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e tij bëhet me kërkesën ose lejen e Rektorit/Administratorit, në UART. Vetëm në rastet e kryerjes së një vepre penale flagrante, në rastet e fatkeqësive natyrore dhe gjendjes së jashtëzakonshme, organet e rendit publik kanë të drejtë të ndërhyjnë edhe pa lejen e autoriteteve drejtuese të UART. Cenimi i paprekshmërisë së UART ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) garantojnë laicitetin e UART;
 - g) Universiteti i Arteve ruan neutralitet politik.

Neni 7

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Veprimtaria e Universitetit të Arteve organizohet dhe realizohet përmes njërive të tij përbërëse, si dhe nga organet dhe autoritetet drejtuese që veprojnë mbështetur në kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në këtë Statut, në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "*Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë*", si dhe në Rregulloret e tjera të miratuara të UART.
2. Universiteti i Arteve vendos në bazë të mësimdhënies traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira botërore e ato evropiane.
3. Universiteti i Arteve e zhvillon veprimtarinë e tij brenda sistemit universitar e të kërkimit artistik/shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në kuadër të detyrimeve me karakter integruar, apo në realizim të marrëveshjeve kombëtare ose ndërkombëtare.
4. Universiteti i Arteve konsideron detyrë themelore të mësuarit, studimit dhe kërkimit artistik/shkencor në bashkëpunim me institucionet vendase dhe nëpërmjet shkëmbimit ndërkombëtar të pedagogëve e të studentëve, në përmbushje të objektivave dhe të programeve të tij.
5. Universiteti i Arteve anëtarësohet në organizma të përhershme, si dhe aktivizohet në organizma dhe veprimtari të përkohshme të arsimit të lartë, artistike-kulturore dhe të kërkimit shkencor në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.
6. Universiteti i Arteve në përputhje me misionin e tij të mësimdhënies, të artit dhe kulturës e të kërkimit artistik/shkencor dhe në respektim të lirisë së individit, harton programe e projekte të veçanta sipas nevojave të fushave të ndryshme. Konkurren me këto projekte në planin



- kombëtar dhe ndërkombëtar për financimin e aktiviteteve artistike, të kërkimit artistik/shkencor dhe teknologjik.
7. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij UART u krijon studentëve kushtet për përvetësimin e dijeve, shprehjen e lirë të mendimit e të organizimit në respektim të kërkesave të bashkëjetesës, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe të Rregullores së tij.
 8. Universiteti i Arteve është institucion laik dhe i depolitizuar.
 9. Universiteti i Arteve si person juridik merr pjesë në veprimtaritë publike e private brenda ose jashtë vendit, në ushtrim të funksioneve dhe në realizim të qëllimeve të tij të ligjshme.

Neni 8
Selia

Selia qendrore e Universitetit të Arteve është në Tiranë, në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza” Nr. 2, Tiranë, Shqipëri. Njësitë e tjera të universitetit janë brenda korpusit qendror.

Neni 9
Universiteti i Arteve

1. Universiteti i Arteve është institucion publik i arsimit të lartë, që vepron në fushën e arsimit, kërkimit artistik/shkencor, veprimtarive krijuese artistike dhe profesionale.
2. Universiteti i Arteve është krijuar në zbatim të VKM Nr. 234, datë 23.01.2011.
3. Universiteti i Arteve është institucion i arsimit të lartë që ofron programe studimi në fusha me veprimtari akademike specifike, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor.
4. Universiteti i Arteve është person juridik publik, që financohet nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme.
5. Statuti i Universitetit të Arteve është dokumenti bazë i rregullimit të veprimtarisë së tij.
6. Statuti i UART miratohet nga Senati Akademik me votat e 2/3 të anëtarëve, pasi është miratuar paraprakisht nga Bordi i Administrimit.

Neni 10
Simbolet e Universitetit

1. Universiteti i Arteve ka stemën e tij, e cila është sipas Lidhjes - 1 të këtij Statuti.
2. Senati Akademik i Universitetit të Arteve, miraton paraprakisht emrin zyrtar dhe stemën e Universitetit të Arteve, apo ndryshimin e tyre. Shenjat dalluese të miratuara paraprakisht i propozohen ministrisë përgjegjëse nga Rektori i Universitetit të Arteve.
3. Universiteti i Arteve ka vulën e vet zyrtare, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
4. Vula e Njërive Kryesore miratohet nga Asambleja e Personelit Akademik.
5. Simbolet e Universitetit të Arteve përfshijnë Stemën e Universitetit dhe Stemat e Fakulteteve.

KREU I DYTË
ORGANIZIMI DHE STRUKTURAT PËRBËRËSE

Neni 11
Njësitë përbërëse të Universitetit të Arteve



1. Universiteti i Arteve përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, të cilat përbëhen secila nga njësitë bazë dhe struktura të tjera ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ.
2. UART mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, përcakton organizimin e brendshëm akademik dhe administrativ të tij.
Brenda UART funksionojnë :
 - **njësitë kryesore**, që janë fakultetet;
 - **njësitë bazë**, që janë departamentet;
 - **njësitë ndihmëse**, janë struktura mbështetëse të përcaktuara në strukturën e UART, të cilat ndihmojnë institucionin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë në realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse, artistike-kërkimore-shkencore dhe atë administrative. Këto njësi janë njësi ndihmëse akademike me karakter mësimor, pjesë të njësive kryesore dhe njësi ndihmës akademik me karakter administrativ, në funksion të njësive bazë, njësive kryesore dhe në nivel institucional.
3. Njësitë kryesore, njësitë bazë, degët dhe njësitë ndihmëse krijohen, mbylLEN, organizohen dhe riorganizohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe këtë Statut, si pjesë e organigramës së UART.
4. Universiteti i Arteve aktualisht përbëhet nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë si më poshtë:
 - Fakulteti i Muzikës
Departamenti Interpretimit
Departamenti Kanto
Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji Muzikore
 - Fakulteti i Artit Skenik
Departamenti Aktrimit dhe Teori
Departamenti Regji dhe Regji Filmi & TV
Departamenti Skenografi & Koreografi
 - Fakulteti i Arteve të Bukura
Departamenti Pikturës
Departamenti Skulpturës
Departamenti Arteve të Aplikuara
5. Rektorati organizohet dhe funksionon sipas dispozitave ligjore në fuqi të përcaktuara në këtë Statut dhe akteve të brendshme.

Neni 12 Fakulteti

1. Fakulteti është njësi kryesore e Universitetit, e cila bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin artistik/shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura.
2. Fakulteti ofron programe të studimeve të cikleve të ndryshme, në përputhje me objektivat e tij akademik dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.
3. Fakulteti organizohet në jo më pak se tre njësi bazë, ku së paku dy prej të cilave janë departamente. Funksionet e tyre përcaktohen në rregulloren e fakultetit.
4. Fakulteti drejtohet nga Dekani, i cili është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i tij. Ai koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre.
5. Fakulteti ka të drejtë të lidhë marrëveshje me njësi të tjera kryesore të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) të tjera, vendase ose të huaja, institucione artistike kulturore vendase



- ose të huaja, institute kërkimore-shkencore, qendra kulturore etj., me qëllim realizimin e aktiviteteve të mësimdhënies, aktiviteteve artistike kulturore, kërkimit artistik/shkencor, kulturor, profesional etj.
6. Fakulteti e mbështet veprimtarinë e tij në ligjin e arsimit të lartë, aktet nënligjore në fuqi, në këtë statut, në rregulloren e Universitetit të Arteve, si dhe në rregulloren e fakultetit.

Neni 13

Departamenti në Universitetin e Arteve

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës artistike-kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore përkatëse. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.
2. Departamenti mund të krijohet edhe nga fakultete të ndryshme të UART, për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor. Në këto raste, funksionimi dhe varësia e këtij departamenti do të përcaktohet me vendim të Senatit Akademik dhe ndryshimeve në statutin e UART.
3. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë artistike-kërkimore-shkencore.
4. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ndahet në grupe mësimore dhe grupe kërkimore artistike-shkencore. Departamenti ka në përbërje edhe personel ndihmës akademik.
5. Departamenti mund të organizohet me grupe mësimore/grupe të përhershme ose të përkohshme, me karakter kërkimor artistik/shkencor. Këto grupe krijohen me vendim të Dekanetit, me votim të hapur. Dekani i Fakultetit pas marrjes të vendimit për ngritjen e grupeve mësimore pranë departamenteve ja përcjell Rektorit të UART për miratim përfundimtar. Titullar i këtij grupi do të caktohet sipas propozimit të drejtuesit të njësisë bazë. Ai nuk ka të drejtë në vendimmarrje por zbaton rregulloret dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe garanton respektimin e lirisë akademike të personelit.
6. Departamenti në fakultetet e UART ushtron këto kompetenca:
 - a) Është përgjegjës për programet e studimit që ofron vetë, për programet ndërdisiplinore të studimit në bashkëpunim me departamentet përkatëse brenda ose jashtë tij, për lëndët përkatëse të tyre dhe gjithë lëndët që mbulohen nga departamente të tjera brenda ose jashtë njësisë kryesore. Harton përmbajtjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse. Kujdeset vazhdimisht për përditësimin e tyre.
 - b) Propozon hapjen, riorganizimin, përshtatjen ose mbylljen e programeve të studimeve.
 - c) Është përgjegjës për fushat artistike-kërkimore-shkencore të tij ose të secilit grup mësimor-artistik-kërkimor në përbërje, kjo në përputhje me saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave artistike-kërkimore-shkencore, për mbulimin e tyre me stafin përkatës në përbërje, për kualifikimin në vazhdim të tij.
 - d) Menaxhon fondet bazë të kërkimit artistik/shkencor dhe fonde të tjera të kërkimit shkencor të fituara nga veprimtari të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare pas miratimit nga autoriteti drejtues i njësisë kryesore.
 - e) Për çdo vit akademik, propozon numrin e studentëve për çdo program studimi në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve shtetërore të cilësisë.
 - f) Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga dekani, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e njësisë kryesore, pjesë përbërëse e së cilës ai është.
 - g) Propozon kriteret e pranimeve në ciklet e studimit për secilin program studimi të ofruar.
 - h) Propozon tarifat e shkollimit për secilin program studimi.
 - i) Mund të ofrojë shërbime për të tretë dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me disiplinat që



- ofron, pas miratimit nga drejtuesi i njësisë kryesore.
- j) Propozon riorganizimin ose mbylljen e njësisë bazë.
 - k) Vlerëson, miraton ose jo dosjet e kandidatëve për fitimin e titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to. Dosjet që plotësojnë kriteret ja përcjell Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë, në përputhje me rregullat e posaçme të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregulloren e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë.
 - l) Ndjek kualifikimin artistik/shkencor në doktoratë sipas Rregullores përkatëse dhe vlerëson dosjet e kandidatëve për gradën shkencore “Doktor” përpara paraqitjes së tyre pranë Komisionit për Gradë Shkencore.
 - m) Paraqet kërkesa për punësimin me kontratë për periudha të shkurtra kohore të studiuësve, personaliteteve, artistëve vendas apo të huaj, për plotësimin e nevojave mësimore, kërkimore artistike dhe shkencore të njësisë bazë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - n) Miraton vitin akademik sabbatik për personelin akademik.
 - o) Përcakton kriteret e punësimit të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, të cilat ja dërgon drejtuesit të njësisë kryesore për miratim.
 - p) Propozon në dekanat listën për personelin akademik me kontratë të përkohshme.
 - q) Përcakton përfaqësuesit e njësisë bazë në komisionet *ad hoc* të punësimit për personelin akademik dhe ndihmës akademik, në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti.
 - r) Përcakton fushat e kërkimit artistik dhe shkencor për doktoratat dhe zhvillon programet e studimit të doktoratave sipas fushave të miratuara.
 - s) Propozon strukturën, kohëzgjatjen dhe kreditet e programeve të formimit të vazhduar.
 - t) Ngre komision për njohjen dhe transferimin e plotë ose të pjesshëm të krediteve dhe njohurive të fituara nga një student që transferohet ose ka aplikuar për rifillimin e studimeve, të cilën ja dërgon drejtuesit të njësisë kryesore për miratim.
7. Departamentet shprehen me vendim për ushtrimin e kompetencave të tyre.

Neni 14

Departamenti i krijuar nga fakultete të ndryshme

1. Departamenti mund të krijohet edhe nga disa njësi kryesore të ndryshme të Universitetit të Arteve për organizimin dhe realizimin e programeve të studimit me karakter ndërdisiplinor.
2. Nisma ndërmerret nga dekanati i çdo fakulteti dhe i propozohet fakultetit me të cilin mendohet realizimi i kësaj forme organizimi. Në këtë rast, nëse dhe dekanati i fakultetit të përfshirë, e pranon në parim si propozim, njësitë e përfshira, ngrenë një grup të përbashkët pune.
3. Si rregull, ky departament është në varësi të atij fakulteti që mbulon pjesën më të madhe të fushës së kërkimit artistik/shkencor dhe/apo të programit të lëndëve që ofrohen nga ky departament, me përjashtim të rastit kur vetë fakultetet miratojnë një varësi të ndryshme.
4. Projekti i hartuar nga grupi i punës duhet që të miratohet nga dekanatet e secilit fakultet të përfshirë dhe i dërgohet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim.
5. Ky departament duhet të përmbushë të gjitha kërkesat që burojnë nga Neni 13.
6. Hapja e këtij departamenti, riorganizimi ose mbyllja e tij bëhet me vendim të Senatit Akademik pas miratimit të Bordit të Administrimit. Hapja ose riorganizimi i tij bëhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 15

Qendra kërkimore e zhvillimit artistik/shkencor



1. Qendra kërkimore-artistike-shkencore (QKASH) është në varësi të njësisë kryesore dhe kryen këto funksione:
 - a) Është përgjegjëse për zgjedhjen e fushave kërkimore-artistike-shkencore të saj ose të secilit departament/grup kërkimor në përbërje, kjo në përputhje me misionin përkatës;
 - b) Është përgjegjëse për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave kërkimore-artistike-shkencore, për mbulimin e tyre me stafin përkatës në përbërje, për kualifikimin në vazhdim të tij.
 - c) Mbështet realizimin e programeve të studimeve, të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose nga departamente të fakulteteve të tjera.
 - d) Organizon aktivitete artistike, shkencore, mësimore, edukuese, ndërgjegjësuere kombëtare dhe ndërkombëtare.
 - e) Është përgjegjëse për krijimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve artistike-kërkimore-shkencore, mësimore, edukuese, ndërgjegjësuere etj.
2. Në varësi të fushës artistike-kërkimore-shkencore të përcaktuar, me vendim të dekanatit mund të bëhet lëvizje e personelit akademik dhe ndihmës akademik për në këtë qendër. Për sa i përket personelit akademik, në këtë rast kërkohet pëlqimi i tyre.
3. Në raste të caktuara mund të vendoset edhe pranimi i personelit akademik sipas rregullave të përcaktuara në Statut.
4. QKASH-ja nëse do të jetë pjesë e strukturës së njësisë kryesore për plotësimin e standardeve të kësaj njësie duhet të përbëhet nga të paktën 7 anëtarë, nga të cilët të paktën 3 të jenë me grada shkencore ose tituj.
5. Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore-Artistike Shkencore zgjidhet në përputhje me kriteret e përcaktuara për drejtuesit e departamentit.
6. Përzgjedhja e anëtarëve të Qendrës bëhet nga Dekanati, sipas fushës së kërkimit artistik/shkencor.
7. Qendra kërkimore-artistike-shkencore duhet të ketë në përbërje edhe personel ndihmës akademik dhe administrativ.

Neni 16

Qendrat studimore ndërdisiplinore

1. Për interesa të përbashkëta studimore, artistike, kërkimore dhe zhvillimore, edukuese etj. njësitë kryesore mund të krijojnë në bashkëpunim, qendra studimore ndërdisiplinore.
2. Nisma do të ndërmerret nga dekanati i çdo fakulteti dhe i propozohet fakulteteve me të cilat mendohet realizimi i kësaj forme organizimi. Në këtë rast, nëse dhe fakultetet e përfshira e pranojnë në parim si propozim, ato ngrenë një grup pune të përbashkët.
3. Qendra studimore ndërdisiplinore ka në përbërje të saj të paktën 3 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik. Në rastet kur kjo qendër është krijuar për interesa kërkimore artistike atëherë personeli akademik i punësuar duhet të ketë tituj akademikë dhe grada shkencore. Veprimtaria e qendrës mbështetet edhe nga personeli i njësisë kryesore pjesëmarrëse në bashkëpunim.
4. Si rregull, kjo qendër është në varësi të atij fakulteti që mbulon pjesën më të madhe të fushës artistike-kërkimore që do të realizohet nga kjo qendër, por njësitë kryesore mund të bien në marrëveshje për përcaktimin e një varësie të ndryshme të qendrës.
5. Hapja e qendrës studimore ndërdisiplinore, riorganizimi ose mbyllja e saj bëhen me propozim të dekanateve të njësisë kryesore bashkëpunuese dhe me vendim të Senatit Akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Hapja e qendrës dhe riorganizimi i saj bëhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 17

Grupet mësimore-artistike-kërkimore brenda departamentit dhe midis departamenteve



1. Departamenti ngre Grupet mësimore-artistike-kërkimore, në përputhje me fushat artistike-kërkimore-shkencore, mbështetur në grup-lëndët kryesore, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret përkatëse si dhe në akte të tjera. Kur është e nevojshme Departamenti ngre Grupe me karakter artistik-kërkimor-mësimor.
2. Grupi është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron programi i studimit. Harton përmbajtjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse, kjo në përputhje me kërkesat e kohës dhe të ekonomisë në vend, për përditësimin në vazhdim të tyre, për mbulimin e tyre me staf të kualifikuar të brendshëm ose të jashtëm.
3. Grupi është përgjegjës për fushat artistike-kërkimore-shkencore të tij dhe të secilit anëtar akademik në përbërje, kjo në përputhje me grup-lëndët mësimore.
4. Grupi është përgjegjës për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave artistike-kërkimore-shkencore, për kualifikimin në vazhdim të tyre.
5. Grupi ka në përbërje të paktën 3 anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, ku të paktën njëri të jetë me titull shkencor.
6. Dy ose më shumë departamente brenda njësisë kryesore mund të vendosin të organizohen në grupe mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore.
7. Grupet mësimore dhe kërkimore artistike/shkencore, brenda dhe midis departamenteve krijohen me vendim të Dekanatit të njësisë kryesore, pasi të jenë propozuar nga njëri departament dhe të jenë miratuar nga departamentet e tjera bashkëpunuese.
8. Struktura, drejtimi dhe funksionimi i grupeve mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore brenda një departamenti apo midis departamenteve përcaktohen në këtë Statut dhe në Rregulloren e brendshme të Njesisë kryesore.

Neni 18

Hapja, riorganizimi ose mbyllja e UART

1. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e Universitetit të Arteve, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit përgjegjës për arsimin. Procedura mund të nisë në dy mënyra:
 - a) Në rast hapje, riorganizimi ose mbylljeje, nisma mund të merret me propozim të Senatit Akademik, pasuar nga miratimi i Bordit të Administrimit. Propozimi për riorganizimin ose mbylljen e UART i përcillet Ministrit përgjegjës për arsimin, i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - b) Në rastin e mbylljes së Institucionit nisma mund të ndërmerret nga ministri përgjegjës për arsimin. Në këtë rast Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit shprehin mendimin brenda një muaji.
2. Struktura e Universitetit të Arteve mund të ndryshojë dhe të pajiset me njësi të reja kryesore apo njësi bazë. Hapja e njësive kryesore të Universitetit të Arteve, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të UART. Nisma bëhet me propozim të Senatit Akademik, pasuar nga miratimi i Bordit të Administrimit. Më tej propozimi për riorganizim, hapje apo mbyllje i përcillet Ministrit përgjegjës për arsimin, i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar nga aktet nënligjore në fuqi. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësive bazë bëhet me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Universiteti i Arteve përcjell vendimin e tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 19

Degët e Universitetit të Arteve

1. Universiteti i Arteve mund të hapë degë për të ofruar programe studimi, në përputhje me



- kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së tij jashtë zonës vendore Tiranë ku ai gjendet sot.
2. Në degët e Universitetit të Arteve përveç mësimdhënies mund të zhvillohen projekte artistike-kërkimore-shkencore, veprimtari trajnuese, shërbime për të tretë dhe veprimtari të tjera në përputhje me këtë Statut dhe rregulloren përkatëse.
 3. Dega e Universitetit të Arteve mund të organizohet:
 - a) si njësi kryesore (nivel fakulteti) e veçantë në strukturën e Universitetit të Arteve;
 - b) si njësi bazë;
 - c) si pjesë përbërëse e njësisë së selisë qendrore të UART.
 4. Në rastin kur dega organizohet si njësi kryesore e Universitetit të Arteve, rektorati harton projektin për krijimin e saj ku përfshihen, selia e ushtrimit të aktivitetit, infrastruktura që do të përdoret, organizimi, funksionimi, struktura, drejtimi, fondet financiare të nevojshme për funksionimin e saj, numrin e stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ që do të jetë pjesë e degës, programet mësimore që do të zhvillohen dhe/apo fushat e kërkimit artistik/shkencor që do të mbulohen.
 5. Bordi i Administrimit të UART shqyrton dhe vendos në lidhje me infrastrukturën që do të përdoren, strukturën, fondet financiare të nevojshme për funksionimin e saj, nivelin e pagave të trupës së pedagogëve dhe të stafit administrativ.
 6. Senati akademik shqyrton dhe vendos për selinë e Degës, numrin e stafit akademik dhe ndihmës akademik që do të jetë pjesë e Degës, organizimin, dhe funksionimin e saj, programet mësimore që do të zhvillohen dhe/apo fushat e kërkimit artistik/shkencor që do të mbulohen nga Dega.
 7. Nëse fakultetet duan të hapin një degë në një tjetër njësi vendore, e cila do të organizohet në formën e njësisë bazë, (departament ose grup mësimor-artistik-kërkimor), atëherë dekanati i atij fakulteti harton projektin për krijimin e saj ku përfshihen, selia e ushtrimit të aktivitetit, infrastruktura që do të përdoren, organizimi, funksionimi, struktura, drejtimi, fondet financiare të nevojshme për funksionimin e saj, numrin e stafit akademik, ndihmës akademik, administrativ që do të jetë pjesë e degës, niveli i pagave të trupës së pedagogëve dhe të stafit administrativ, programet mësimore që do të zhvillohen dhe/apo fushat e kërkimit artistik/shkencor që do të mbulohen. Në këtë rast Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik, veprojnë sipas pikave 5 dhe 6 të këtij neni.

Neni 20

Institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit brenda fushave të UART

1. Universiteti i Arteve, në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, si edhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të marrë pjesë në krijimin dhe administrimin e Instituteve apo Qendrave institucionale të kërkim-zhvillimit sipas fushave të tij specifike.
2. Për Universitetin e Arteve, rektorati është struktura kompetente për ndërmarrjen e kësaj nisme dhe për propozimin e saj tek një IAL tjetër, ose për shqyrtimin e propozimit që vjen nga IAL-të e tjera. Në këtë rast, Universiteti i Arteve dhe IAL tjetër bien në parim dakord me propozimin. Rektorati ka të drejtë që, në varësi të dakortësisë, të emërojë përfaqësuesit e saj në një grup të përbashkët pune.
3. Si rregull, ky institut apo qendër është në varësi të asaj IAL që mbulon pjesën më të madhe të fushës së kërkimit shkencor/artistik dhe/apo të programit të lëndëve që ofrohen nga kjo strukturë, me përjashtim të rastit kur vetë IAL-të miratojnë një varësi të ndryshme.
4. Projekti i hartuar nga grupi i punës, mbasi është miratuar paraprakisht nga Rektorati, i dërgohet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim.

Neni 21

Biblioteka Shkencore e Universitetit të Arteve



1. Biblioteka Shkencore e Universitetit të Arteve është bibliotekë publike shtetërore, dhe sipas misionit të saj klasifikohet në llojin Bibliotekë Universitare, por luan edhe rolin e një biblioteke speciale për të gjitha fushat e artit në Shqipëri dhe ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në edukimin dhe formimin e artistëve të rinj.
2. Misioni i saj është mbështetja e procesit mësimor, veprimtarisë krijuese artistike-shkencore, dhe i shërben studentëve, stafit akademik dhe kërkueseve të artistëve nga institucione të ndryshme të artit brenda dhe jashtë vendit.
3. Biblioteka Shkencore e UART, siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës. Në raste të veçanta, tarifatat për shërbimet speciale të ofruara në Bibliotekën Shkencore të UART, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi si dhe nga Bordi i Administrimit të UART.
4. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës Shkencore në UART, përcaktohet në rregulloren e saj të miratuar nga Senati Akademik.

KREU III

ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Neni 22

Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit të Arteve është Senati Akademik, i cili është organ kolegjal. Organe të tjera akademike janë Asambleja e Personelit Akademik dhe Komisionet e Përhershme.
2. Autoritetet drejtuese akademike të UART janë Rektori, Dekani, Drejtuesi i Njësisë Bazë.
3. Organi më i lartë drejtues administrativ i UART është Bordi i Administrimit.
4. Autoriteti drejtues administrativ i UART është Administratori i institucionit.
5. Organe të tjera kolegjiale të UART janë: Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës.
6. Anëtarët e Senatit Akademik dhe autoritetet drejtuese akademike të UART zgjidhen, nëpërmjet një procesi të përgjithshëm zgjedhor, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
7. Anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë dhe akteve të tjera nënligjore. Autoriteti drejtues administrativ përzgjidhet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve të këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi.
8. Anëtarët e Senatit, Bordit, Anëtarët e Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit të Etikës, shpërblehen financiarisht në përputhje me kontributet e tyre. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve sipas kuadrit ligjor në fuqi.
9. Anëtarët e KIZ-it, të KZF dhe të Komisionit të Apelimit, të cilët përfshihen në procesin e organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve, shpërblehen për punën që bëjnë në masën e një page mujore për vitin që angazhohen në zgjedhje. Shpërblimi miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UART.

Neni 23

Senati Akademik

1. Organi kolegjal më i lartë akademik i Universitetit të Arteve është Senati Akademik. Senati kryesohet nga Rektori. Senati mbledhet periodikisht.
2. Anëtarët e Senatit Akademik i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rastet kur nuk ka kandidatura të tjera me këtë titull/gradë dhe për efekt të përfaqësimit, mund të



- kandidojë edhe personeli akademik me kohë të plotë me gradën “Doktor” të fituar në Shqipëri.
3. Senati Akademik i UART përbëhet nga 19 anëtarë, 4 përfaqësues për çdo fakultet, 2 përfaqësues të studentëve. Rektori, Zëvendës rektori për anën mësimore dhe dekanët e fakulteteve automatikisht janë pjesë e Senatit Akademik.
 4. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të personelit akademik, zgjidhen me shumicë votash nga asambljetë e personelit akademik të njëjste kryesore përkatëse, përmes një votimi të përgjithshëm. Ata zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar. Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve, zgjidhen nga studentët. Mund të jenë përfaqësues të studentëve vetëm ata shtetas që janë studentë në Universitetin e Arteve në çastin e zgjedhjes së tyre. Anëtarët e Senatit Akademik zgjidhen në përputhje me Rregulloren e Zgjedhjeve të hartuar nga UART.
 5. Senati Akademik në mbledhjen e tij të parë me propozim të Rektorit, zgjedh nënkryetarin.
 6. Senati Akademik me propozim të Rektorit miraton sekretariatit e tij i cili merret me gjithë anën procedurale të dokumentacionit dhe jo vetëm, në funksion të tij.
 7. Anëtarit të Senatit Akademik i mbaron mandati në mënyrë të parakohshme në rastet kur:
 - a) përfundon marrëdhënia e punës apo studimet në Universitetin e Arteve;
 - b) mungon pa arsye në më shumë se tre mbledhje për një periudhë kohore 6 mujore;
 - c) jep dorëheqjen nga anëtarësia në Senat;
 - ç) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
 - d) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - dh) në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - e) kur mbush moshën e pensionit;
 - ë) kur rezulton pozitiv gjatë kontrollit të dekriminalizimit dhe bashkëpunëtorit me sigurimin e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
 8. Senati ngre një komision *ad hoc* të përbërë nga pesë anëtarë, i cili shqyrton rastet e shkarkimit dhe të përfundimit të mandatit para kohe të anëtarëve të tij dhe ia propozon Senatit, i cili vendos me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.
 9. Vendi i mbetur i lirë plotësohet sipas renditjes në listën përkatëse të kandidatëve gjatë votimit për Senatin Akademik. Kur nuk ka të tillë, Rektori thërret zgjedhjet për anëtar të Senatit Akademik.

Neni 24

Funksionet e Senatit Akademik të UART

1. Funksionet e Senatit Akademik janë:
 - a) Garanton autonominë e universitetit, lirinë akademike dhe të drejtat e studentëve.
 - b) Garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë.
 - c) Garanton realizimin e objektivit për një universitet të bazuar në kërkimin artistik-shkencor, si dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore të personelit akademik.
 - d) Miraton paraprakisht planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit mësimor dhe të kërkimit artistik/shkencor dhe ia propozon për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.
 - e) Pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit, miraton, me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, Statutin e universitetit dhe ia përcjell për miratim ministrit përgjegjës për arsimin.
 - f) Harton dhe miraton paraprakisht strukturën e përgjithshme dhe organizative të personelit të universitetit, dhe ja dërgon për miratim Bordit të Administrimit numrin e personelit në të gjitha nivelet e UART.



- g) Miraton rregulloret e universitetit.
- h) Miraton rregulloret e tjera me karakter akademik.
- i) Miraton programet e reja të studimit. Këto duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit. Miraton ndryshimet si dhe mbylljen e tyre.
- j) Miraton programet e reja të kërkimit artistik dhe shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre.
- k) Propozon riorganizimin ose mbylljen e universitetit, ndarjen, bashkimin me institucion/e të tjera të arsimit të lartë.
- l) Miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive dhe degëve të universitetit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, pas vlerësimit paraprak të Bordit të Administrimit.
- m) I paraqet kërkesë ministrisë përgjegjëse për arsimin për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe akreditimin e programeve të studimit, departamenteve, fakulteteve, apo vetë universitetit.
- n) I propozon ministrisë përgjegjëse për arsimin hapjen, mbylljen, ndryshimin dhe emërtimin e njësive kryesore dhe të programeve të studimit.
- o) Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së universitetit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- p) Shqyrton dhe vlerëson kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin për hapjen e programeve të reja të arsimit në fusha parësore.
- q) Zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit të UART.
- r) Miraton listën e kandidaturave që plotësojnë kriteret për administrator të Universitetit të Arteve.
- s) Ngre komisione të përhershme të tij për të ndjekur drejtimet më të rëndësishme të veprimtarisë së institucionit dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre.
- t) Ngre Komisionin e Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik.
- u) Ngre Komisionin *ad hoc* për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues me punën kërkimore–shkencore në zbatim të VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, për promovimin e personelit akademik me gradë shkencore.
- v) Miraton pozicionet e lira të punës për personelin e ftuar me arritje në veprimtari krijuese dhe interpretuese në zbatim të VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021.
- w) Ngre komision ad-hoc për kërkesat e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021.
- x) Miraton ekuivalentimin e aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, për të vlerësuar performancën akademike vjetore, për secilin fakultet në UART, në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021.
- y) Miraton paraprakisht dhe i dërgon për miratim Bordit të Administrimit buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të Universitetit të Arteve.
- z) Miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-artistike dhe shkencore.
- aa) Miraton kuotat e pranimeve në Universitetin e Arteve mbi bazën e propozimeve nga njësitë kryesore, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
- bb) Organizon në bashkëpunim me Bordin e Administrimit mbledhjen e përbashkët, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimin artistik/shkencor dhe atë financiar.
- cc) Përcakton drejtimet kryesore të bashkëveprimeve të universitetit dhe njësive kryesore të tij me të tretët.
- dd) Miraton anëtarësimin e universitetit në organizata kombëtare e ndërkombëtare arsimore e shkencore, lidhjet e binjakëzimit me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me organizma jofitimprurës, donatorë vendas e të huaj që mund të ndihmojnë në zhvillimin e universitetit, si dhe marrëveshjet që




- Rektori i përcjell për miratim.
- ee) Miraton pranimin e donacioneve vendase apo të huaja, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, pas shqyrtimit të Bordit të Administrimit.
 - ff) Shqyrton dhe miraton propozimin e njësisë kryesore apo të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik për dhënien e titujve “*Doctor Honoris Causa*” personaliteteve të artit, shkencës, kulturës, politikës dhe ekonomisë, vendas dhe të huaj.
 - gg) Jep në vlerësim të veprimtarisë së spikatur akademike, titullin “*Profesor emeritus*” për anëtarë të personelit akademik të Universitetit të Arteve që mbajnë titullin “Profesor”, pas daljes në pension, me propozim të njësisë bazë ku kanë zhvilluar karrierën.
 - hh) Vendos kriteret për shpërndarjen e bursave në fakultete, si dhe përcakton kriteret e shpërblimit për studentët e shkëlqyer të Universitetit të Arteve.
 - ii) Përcakton kriteret e shpërblimit për personelin akademik që është shquar në realizimin e një detyre të caktuar të një rëndësie të veçantë.
 - jj) Thërret Administratorin e Universitetit të Arteve për të raportuar për veprimtarinë e tij, të paktën dy herë në vit.
 - kk) Interpretin Statutin e Universitetit të Arteve, si dhe shqyrton e zgjidh konfliktet midis rregulloreve të njësisë përbërëse të tij.
 - ll) Miraton Rregulloren e tij të funksionimit.
 - mm) Mbikëqyr zbatimin e detyrave të lëna në planin vjetor të veprimtarisë akademike, kërkimore artistike e shkencore të Universitetit të Arteve.
 - nn) Miraton rastet e trajtimit të posaçëm të pedagogëve, në projekte artistike, studiuesve dhe studentëve me aftësi e rezultate veçanërisht të larta e të rëndësishme.
 - oo) Përzgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës, si dhe miraton Kodin e Etikës dhe Rregulloren e funksionimit të Këshillit të Etikës.
 - pp) Kur e çmon të arsyeshme dhe të nevojshme, ngre grupe pune të përbëra nga anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me qëllim hartimin e dokumenteve të ndryshme, studimin e ngjarjeve të veçanta apo realizimin e veprimtarive të tjera.
 - qq) Merr vendime për çështje që janë të kompetencës së tij, mbi bazën e propozimit të secilit prej anëtarëve të tij.

Neni 25

Mënyra e funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve

1. Senati Akademik i UART e ushtron veprimtarinë e tij në mbledhjen e përgjithshme si edhe nëpërmjet komisioneve të krijuara prej tij.
2. Senati Akademik kryesohet nga Rektori dhe në mungesë të tij nga nënkryetari.
3. Në mbledhjen e Senatit marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Anëtari që e ka të pamundur pjesëmarrjen, duhet të njoftojë për arsyen e mungesës së tij, mundësisht 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.
4. Mbledhjet e Senatit Akademik mbahen bazuar në planifikimin që ka bërë vetë Senati Akademik në mbledhjen e tij të mëparshme, me kërkesë të Rektorit ose të një të tretës së anëtarëve të tij. Asnjë çështje tjetër nuk mund të diskutohet jashtë atyre të përcaktuara në rendin e ditës, me përjashtim të rastit kur vetë Senati Akademik me dy të tretat e votave të tij vendos për përfshirjen e çështjeve të tjera.
5. Mbledhjet e Senatit Akademik, janë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Konsiderohen mbledhje të jashtëzakonshme ato që mbledhen jashtë radhe për çështje të ndjeshmërisë së lartë që prekin institucionin ose asetet e tij. Mbledhjet e zakonshme u njoftohen anëtarëve të Senatit Akademik, në postën e tyre elektronike zyrtare të paktën 3 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes. Mbledhjet e jashtëzakonshme u njoftohen anëtarëve të Senatit Akademik, të paktën 24 orë përpara zhvillimit të mbledhjes.
6. Mbledhjet e Senatit Akademik, kur shikohet e nevojshme mund të regjistrohen me mjete të



teknologjisë së informacionit. Sekretariati i Senatit Akademik mban procesverbal për çdo mbledhje të tij. Sekretariati publikon Vendimet brenda 72 orëve, në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Arteve.

7. Mbledhjet e Senatit Akademik janë të vlefshme nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, Rektori vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, e cila duhet të mbahet jo më parë se 3 ditë nga dita e planifikuar e mbledhjes së thirrur.
8. Si rregull votimet në Senatin Akademik janë të hapura. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë të vlerësuar/paraqitura nga Këshilli i Etikës. Votimi i fshehtë realizohet edhe kur e kërkojnë të paktën një e pesta e anëtarëve të Senatit Akademik.
9. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës.
10. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se, në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të ketë përsëri barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur.
11. Anëtarët e Senatit Akademik, që kanë votuar kundër kanë të drejtë të kërkojnë që në procesverbal të shënohet fakti dhe arsyet e këtij votimi.
12. Veçori të tjera të funksionimit të Senatit akademik të UART përcaktohen në Rregulloren e Universitetit të Arteve.

Neni 26

Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare.
2. Rektori mban titullin “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të UART ose dhe jashtë tij.
3. Rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njëjësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e Rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave. Kandidatët për Rektor vetëkandidohen dhe duhet që të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të kenë përvojë në mësimdhënie dhe krijimtari artistike ose kërkimore shkencore jo më pak se 10 vjet në IAL;
 - b) Të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 vitesh;
 - c) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - d) Të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10 034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrjnë funksione publike”.
3. Zgjedhja e Rektorit realizohet në përputhje me ligjin dhe Rregulloren e Zgjedhjeve të hartuar nga UART.
4. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
5. Rektori i zgjedhur dekretohet nga Presidenti i Republikës.
6. Rektori shkarkohet nga Presidenti i Republikës në rastet e përfundimit të parakohshëm të



mandatit, sipas përcaktimeve të këtij Statuti, me propozim të Ministrit përgjegjës për arsimin. Në rastin e largimit të Rektorit para përfundimit të mandatit të tij, detyrën e Rektorit e kryen një prej zëvendës rektorëve. Ky i fundit komandohet në detyrë nga ministri përgjegjës për arsimin, për një afat deri në gjashtë muaj, me qëllim organizimin e zgjedhjeve.


7. Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera në të gjithë Universitetin përcaktohen në Rregulloren e përgjithshme të Universitetit të Arteve.

Neni 27

Funksionet e Rektorit

1. Rektori kryen funksionet si më poshtë:

- a) Drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij.
- b) Nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik me kohë të plotë, të shpallur fitues nga Komisioni përkatës i marrjes në punë.
- c) I paraqet Senatit planin strategjik të zhvillimit të institucionit.
- d) I kërkon informacion Bordit të Administrimit për çështje të kompetencës së tij.
- e) Paraqet kërkesat akademike, administrative dhe financiare tek administratori i institucionit.
- f) Nënshkruan titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to, pas miratimit të tyre.
- g) Nënshkruan diplomat për të gjitha ciklet e studimeve që ofron Universiteti i Arteve, pa të drejtë delegimi.
- h) Trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- i) Ushtron kontrolle, kryesisht apo me kërkesë të organeve drejtuese të Universitetit të Arteve për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit artistik/shkencor, zbatimit të kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër që kryejnë fakultetet.
- j) Ka të drejtën e delegimit të firmës dhe të kompetencave të tij, zëvendës rektorëve.
- k) Miraton strukturën e vitit akademik në shkallë universiteti, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- l) Autorizon në rast nevojë hyrjen e forcave të rendit në mjediset e Universitetit të Arteve.
- m) Shton për diskutim në rektorat ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve.
- n) Emëron dhe shkarkon zëvendës rektorët pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.
- o) Është autoriteti i vetëm kontraktues për anën akademike dhe çështjet protokollare në nivel institucional. Në disa raste, sipas gjykimit të tij, ai mund të delegojë të drejtën e firmës njërit nga zëvendës rektorët.
- p) Marrëdhëniet e Rektorit me organet e tjera, mënyra dhe kushtet e ushtrimit të kompetencave të tij parashikohen në rregulloren e përgjithshme të Universitetit të Arteve.
- q) Përcakton fushën e veprimit të zëvendës rektorëve dhe bën ndryshimin e tyre kur e gjen të nevojshme për nevoja të institucionit në rastet dhe mënyrën e parashikuar në Rregullore.
- r) I propozon ministrit përgjegjës për arsimin shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive kryesore të institucionit publik, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës së Universitetit të Arteve. Rektori, brenda dy muajve nga data e shkarkimit, cakton njërin prej zëvendësve të autoritetit deri në zgjedhjen e autoritetit të ri. Rektori, menjëherë pas shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme, të cilat kryhen brenda gjashtë muajve nga data e shkarkimit.
- s) Kur e çmon të arsyeshme ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Bordit të



Administrimit ku mund të paraqesë sugjerime, opinione, rekomandime me qëllim përmirësimin e punës, orientimin më të mirë në administrimin e institucionit.


- t) Kur e çmon të arsyeshme dhe të nevojshme, ngre grupe pune me qëllim kontrolli, studimi apo veprimtari të tjera të veçanta.
 - u) Lidh sipas rastit marrëveshje me subjekte të tjera pas marrjes së miratimit nga Senati Akademik.
 - v) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me karakter akademik në nivel të Institucioneve të arsimit të Lartë dhe monitoron zbatimin e tyre.
 - w) Ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit.
2. Rektori në ushtrim të funksioneve të tij shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.

Neni 28 Zëvendësrektori

1. Universiteti i Arteve ka dy zëvendës rektorë, të cilët ndahen në:
 - a) Zëvendësrektor për anën mësimore;
 - b) Zëvendësrektor për anën artistike-kërkimore-shkencore;
2. Zëvendësrektorët ndihmojnë Rektoren në realizimin e detyrave të tij dhe mund të ushtrojnë edhe detyra të tjera bazuar në urdhrin e Rektorit.
3. Në rast mungese të tij, Rektori autorizon njërin prej zëvendësrektorëve në ushtrimin e detyrave të tij, me përjashtim të rastit kur në këtë Statut përcaktohet ndryshe.
4. Zëvendësrektor mund të jetë vetëm anëtari i personelit akademik me kohë të plotë. Ai duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Ti përkasë kategorisë “Profesor” ose të ketë mbrojtur gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së.
 - b) Të ketë përvojë në mësimdhënie ose kërkim artistik/shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
 - c) Të ketë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, të ketë zhvilluar kurrikula, programe të lëndëve, të ketë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të ketë zhvilluar projekte kërkimore, artistike etj.;
 - d) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - e) Të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - f) Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10 034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
5. Rektori i propozon Senatit Akademik kandidatët për zëvendësrektor. Senati Akademik vlerëson plotësimin e kërkesave të mësipërme dhe miraton ose jo kandidaturat e propozuar.
6. Rektori i propozon Senatit Akademik shkarkimin e zëvendësrektorit nga kjo detyrë në rast të mos kryerjes së detyrave ose në rast të shkeljeve të rënda në kryerjen e këtyre detyrave.
7. Marrëdhëniet e zëvendësrektorit me organet e tjera në të gjithë Universitetin e Arteve, përcaktohen në rregulloren e UART.

Neni 29 Rektorati

1. Rektorati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Rektori dhe ka në përbërje të tij:
 - a) Zëvendësrektorët e UART;




- b) Drejtuesit e njësive kryesore të UART;
 - c) Administratorin e UART;
2. Në mbledhjen e rektoratit sipas nevojës mund të ftohen edhe funksionarë të tjerë të Universitetit të Arteve dhe/apo të njësive të tjera.
 3. Rektorati ushtron këto kompetenca:
 - a) harton planin strategjik të zhvillimit të Universitetit mbi bazën e propozimeve të njësive bazë dhe ato kryesore;
 - b) propozon hapjen, mbylljen apo riorganizimin e njësive kryesore dhe njësive të tjera të veçanta;
 - c) jep mendim për tematika dhe probleme, të cilat prekin funksionimin dhe autonominë e Universitetit të Arteve;
 - d) formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - e) përcakton përparësitë në plotësimin e kërkesave të njësive të institucionit për financime, mbi të cilat do të hartohet projekt-buxheti vjetor;
 - f) paraqet rekomandime në Senat mbi strukturën e përgjithshme organike dhe analitike si dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet;
 - g) paraqet në Senat për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore artistike/shkencore;
 - h) paraqet rekomandime në Senat mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare/ndërkombëtare;
 - i) merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik;
 - j) paraqet në senat kodin e etikës;
 - k) harton dhe paraqet për miratim rregulloren e Universitetit të Arteve;
 - l) trajton dhe merr vendim për ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve;
 - m) trajton dhe zgjidh mosmarrëveshjet mes drejtuesve të njësive kryesore;
 - n) ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë statut dhe akte të tjera të Universitetit.
 4. Rektorati mblidhet rregullisht, çdo javë, por në çdo rast, jo më pak se dy herë në muaj. Mbledhja e Rektoratit thirret nga Rektori, ose të paktën një e treta e anëtarëve të tij. Për çdo mbledhje të Rektoratit mbahet procesverbal. Rektorati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim.
 5. Rektorati harton rregulloren e funksionimit të tij, e cila miratohet nga Senati Akademik.

Neni 30

Komisionet e Përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjinale të krijuara në nivel institucional, të cilat mbulojnë fusha të përcaktuara në këtë statut. Me përjashtim të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, Komisionet e përhershme të Senatit Akademik e ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe marrin vendime sipas kompetencave të parashikuara në ligj dhe në këtë statut, ose i propozojnë mbledhjes së Senatit Akademik miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit.
2. Përbërja e komisioneve të përhershme përcaktohet nga Senati Akademik. Në çdo rast një anëtar i komisioneve respektive nga kategoria personel akademik mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar i personelit akademik. Një anëtar i komisioneve respektive nga kategoria student mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar student.
3. Senati Akademik ngre komisionet e përhershme si më poshtë:
 - a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.
 - b) Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.
 - c) Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët.
4. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve përcaktohet nga Rregullorja e



Universitetit të Arteve, e cila përmban rregulla të ndryshme për formimin, përbërjen dhe funksionimin e komisioneve.

5. Një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë mund të jetë anëtar në jo më shumë se 2 komisione të përhershme. Një anëtar i personelit akademik me kohë të plotë nuk mund të jetë kryetar në më shumë se 1 komision të përhershëm. Ky rregull nuk zbatohet për komisionet *ad hoc*.
6. Kryetarët e komisioneve zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë votash të të gjithë anëtarëve.
7. Anëtarët e komisioneve zgjidhen për një mandat dy vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
8. Brenda javës së parë të muajit Dhjetor të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen e Senatit Akademik raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.

Neni 31

Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik

1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, është struktura përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to në Universitetin e Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë. Ata vetë kandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Anëtarët e Komisionit, duhet që të plotësojnë këto kritere:
 - a) të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b) të mbajnë titullin “Profesor” dhe të kenë së paku pesë vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.
4. Komisioni vendos me shumicën e votave të gjithë anëtarëve dhe me votim të fshehtë.
5. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në Rregulloren e tij.
6. Gjatë veprimtarisë së tij, Komisioni zbaton kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për vlerësimin e kandidatëve dhe dhënien e titujve akademikë.
7. Komisioni për vlerësimin e dhënies së titujve akademikë në Universitetin e Arteve, ka kompetencë të plotë në verifikimin e dokumentacionit të depozituar prej secilit aplikant, duke u mbështetur në kriteret përkatëse dhe mban përgjegjësi për çdo vlerësim të tyre.
8. Rregullime të tjera mbi procedurën për dhënien e titujve akademikë parashikohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Për Promovimin e Personelit Akademik.

Neni 32

Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”

1. Pranë njësave kryesore të UART krijohen komisionet e përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
2. Këto komisione përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e personelit akademik. Anëtarët e këtyre komisioneve duhet të gëzojnë të paktën titullin akademik “Profesor i asociuar” dhe të jenë prej jo më pak se 5 (pesë) vjet personel akademik me kohë të plotë në UART.
3. Asambleja e personelit akademik vendos miratimin e kandidaturave për anëtarë të komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
4. Komisioni vendos me shumicën e votave të gjithë anëtarëve dhe me votim të fshehtë.
5. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në Rregulloren e tij.
6. Gjatë veprimtarisë së tij, Komisioni zbaton kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për vlerësimin e kandidatëve dhe dhënien e gradave shkencore.



Neni 33


Komisioni *ad hoc* për Ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”

1. Komisioni *ad hoc* për ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, ngrihet me vendim të posaçëm të Senatit Akademik të UART.
2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë. Ata vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Anëtarët e Komisionit, duhet që të plotësojnë këto kritere:
 - a) të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
 - b) të mbajnë titullin “Profesor” dhe të kenë së paku dhjetë vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli.
4. Komisioni vendos me shumicën e votave të gjithë anëtarëve, me votim të fshehtë dhe më pas ja dërgon Senatit Akademik për miratim.
5. Organizimi, funksionimi dhe kriteret për ekuivalentimin e gradës shkencore mbështetur mbi aktivitetin artistik për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar, i këtij Komisioni përcaktohet në Rregulloren e tij të miratuar nga Senati Akademik.
6. Gjatë veprimtarisë së tij, Komisioni zbaton kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në rregulloren e miratuar nga Senati Akademik i UART për ekuivalentimin e aktivitetit artistik të stafit krijues dhe interpretues me gradën shkencore për efekt të mësimdhënies.
7. Anëtarët e Komisionit *ad hoc* për Ekuivalentimin e gradës shkencore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar shpërblehen financiarisht për punën e kryer në masën e një page mujore në vit sipas kategorisë. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve.

Neni 34

Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët

1. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët ngrihet për të garantuar dhe për të zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të Universitetit të Arteve dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik dhe 3 anëtarë përfaqësues të studentëve dhe 1 specialisti i kurrikulës dhe informimit të studentëve. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Komisioni ushtron këto funksione:
 - a) harton politikën për trajtimin e studentëve;
 - b) bashkëpunon me Këshillat Studentorë dhe koordinon punën me ta;
 - c) propozon mbështetjen financiare dhe logjistike të projekteve të studentëve;
 - d) kërkon informacione të ndryshme nga njësitë kryesore për probleme të studentëve;
 - e) kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre.
3. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.
4. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në Rregulloren e tij, të miratuar



nga Senati Akademik i UART.

Neni 35


Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

1. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit.
2. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 anëtarë. Në përbërje të KPSBC-së zgjidhet nga një përfaqësues nga secili Fakultet i UART, një përfaqësues specialisti i NJSBC-së pranë UART, një përfaqësues nga studentët. Përfaqësuesit e fakulteteve në këtë komision duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të ngarkuar nga Dekanati për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në fakultet përkatëse. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e Komisionit, pjesë e personelit akademik, duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a) të kenë minimalisht gradën shkencore “Doktor”;
 - b) të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
 - c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
3. Anëtari i Komisionit, përfaqësues i studentëve duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9.
4. Në rastet kur UART i nënshtrohet procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit institucional dhe ose programeve të studimit të ofruara, kur është e nevojshme, thirret edhe një ekspert i jashtëm.
5. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.
6. Organizimi dhe funksionimi i këtij Komisioni përcaktohet në këtë Statut dhe në Rregulloren e tij të miratuar nga Senati Akademik i UART.

Neni 36

Këshilli i Etikës

1. Këshilli i Etikës është organ kolegjal i Universitetit të Arteve.
2. Këshilli i Etikës promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale sipas parashikimeve të Kodit të Etikës dhe legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
3. Këshilli ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë me nismën e tij informacione nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ dhe njësitë përbërëse të Universitetit të Arteve lidhur me respektimin e kërkesave të moralit dhe të etikës në realizimin të funksioneve e detyrave të secilit.
4. Këshilli i Etikës merr vendime me shumicë votash dhe i paraqet rekomandimet e tij Senatit Akademik.
5. Këshilli i Etikës përbëhet nga 5 anëtarë.
6. Secili Fakultet gëzon të drejtën e përfaqësimit me një anëtar nga stafi akademik i kategorisë Profesor, i vetëkandiduar. Anëtari duhet të ketë një eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART.
7. Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është anëtar i Senatit Akademik të UART. Anëtari përfaqësues i Senatit Akademik duhet të ketë një eksperiencë pune mbi 10 (dhjetë) vite në UART dhe të jetë i kategorisë Profesor.
8. Njëri nga anëtarët e Këshillit të Etikës është nga kategoria Student i UART.
9. Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



10. Këshilli i Etikës i propozon për miratim Senatit Akademik Kodin e Etikës të Universitetit të Arteve. Projekt kodi i përgatitur nga Këshilli i Etikës, përpara se të dërgohet për miratim në Senatin Akademik, duhet të kalojë për konsultim në të gjitha njësitë bazë dhe kryesore të Universitetit të Arteve.
11. Mënyra e shqyrtimit të ankesave, vendimet, sanksionet përkatëse dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve, parashikohen në Kodin e Etikës dhe në Rregulloren e tij, e cila hartohet nga Këshilli i Etikës dhe miratohet në Senatin Akademik të UART.

Neni 37

Njësi të tjera ndihmëse në nivel institucioni

1. Pranë Rektoratit të Universitetit të Arteve në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, funksionojnë disa struktura ndihmëse me karakter akademik, të cilat janë të përbëra nga personel ndihmës akademik me karakter administrativ në nivel institucional janë:
 - a) Struktura e kurrikulave dhe informimit të studentëve;
 - b) Struktura e kërkimit artistik/shkencor;
 - c) Struktura e projekteve;
 - d) Struktura e promovimit akademik dhe botimeve;
 - e) Struktura e marrëdhënieve me publikun;
 - f) Struktura e marrëdhënieve me jashtë;
 - g) Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
 - h) Struktura e karrierës dhe koordinimit institucional;
 - i) Struktura e bibliotekës;
 - j) Struktura juridike;
 - k) Struktura e teknologjisë së informacionit;
 - l) Struktura e burimeve njerëzore;
 - m) Struktura e arkiv-protokollit;
 - n) Asistenti/ja Rektorit;
2. Këto struktura ndihmojnë në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe /ose të kërkimit artistik/shkencor dhe/ose të zhvillimit administrativ të UART. Rektorati ka të drejtë që të propozojë struktura të reja në përmbushjen e kompetencave të tij si dhe në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Mënyra e funksionimit të strukturave të lartpërmendura përcaktohet në Rregulloren e UART si dhe të Rektoratit, të miratuara nga Senati Akademik.
4. Pranë çdo njësie kryesore funksionojnë disa struktura ndihmëse me karakter akademik, të cilat janë të përbëra nga personel ndihmës akademik me karakter administrativ sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 38

Asambleja e personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisive kryesore.
2. Asambleja e njësisë kryesore drejtohet nga Dekani dhe ka këto funksione:
 - a) zgjedh rektorin e universitetit;
 - b) zgjedh anëtarët e Senatit Akademik;
 - c) zgjedh drejtuesit e njësisë kryesore;
 - d) krijon komisionet e përhershme të njësisë kryesore dhe zgjedh anëtarët e tyre;
 - e) Merr në analizë aktivitetin e fakultetit dhe autoriteteve të tij.
3. Asambleja e personelit akademik e ushtron veprimtarinë e saj në mbledhjen e përgjithshme si



edhe nëpërmjet komisioneve. Asambleja mbledhet sipas rendit të ditës të vendosur, të paktën një herë gjatë vitit akademik. Ajo mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me një rend të caktuar me nismën e drejtuesit, ose me kërkesë me shkrim nga një e treta e anëtarëve. Mbledhja e asamblesë së personelit akademik zhvillohet kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë (50% + 1) të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

4. Mënyra e funksionimit të asamblesë së personelit akademik përcaktohet në Rregulloren e njësisë kryesore.
5. Rregullorja e njësisë kryesore hartohet dhe miratohet nga vetë njësia përkatëse dhe më pas i përcillet Senatit Akademik, i cili e miraton atë me një vendim të posaçëm.

Neni 39

Drejtuesi i njësisë kryesore Dekani

1. Dekani i fakultetit është autoriteti më i lartë drejtues i njësisë kryesore. Ai është përfaqësuesi ligjor dhe autoriteti më i lartë akademik dhe protokollar i saj.
2. Dekani zgjidhet nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore dhe nga studentët. Kandidati për drejtues vetëkandidohet. Ai është personel akademik i kategorisë “Profesor” dhe mund të vijë nga radhët e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë ose dhe jashtë tij. Kandidatët për dekan duhet:
 - a) Të kenë përvojë në mësimdhënie dhe krijimtari artistike ose kërkimore shkencore jo më pak se 10 vjet në IAL;
 - b) Të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe/ose të kenë zhvilluar projekte artistike-kërkimore-shkencore etj., prej të paktën 5 vitesh;
 - c) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
 - d) Të mos jenë dënuar më parë me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - e) Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
3. Mandati i drejtuesit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit akademik të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
4. Rektori i UART emëron drejtues të njësisë kryesore kandidatin fitues, dalë nga zgjedhjet.
5. Kur vendi i Dekanit mbetet i lirë, si pasojë e përfundimit të parakohshëm të mandatit për arsyet e paracaktuara në Statut, Rektori komandon në detyrë zëvendës dekanin deri në organizimin e zgjedhjeve.


Neni 40

Funksionet e Dekanit

1. Dekani:
 - a) koordinon veprimtarinë e njësive bazë dhe organeve kolegjiale të njësisë kryesore, si dhe zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet tyre;
 - b) drejton asamblenë e njësisë kryesore;
 - c) emëron Përgjegjësit e Njësive Bazë të dalë nga zgjedhjet e njësive përkatëse;
 - d) propozon tek Rektori shkarkimin e autoritetit drejtues të njësive bazë në rastet e parashikuara në Statut. Njëkohësisht, Dekani propozon tek Rektori caktimin e zëvendësuesit të autoritetit drejtues të shkarkuar;



- e) emëron dhe shkarkon zëvendës dekanin;
- f) propozon hapjen, mbylljen ose riorganizimin e njësive bazë pas marrjes së mendimit nga njësia bazë ekzistuese. Në rast të krijimit të një njësie të re bazë ose të mbylljes së një njësie ekzistuese, merr mendimin e të gjitha njësive bazë dhe të administratorit të UART mbi kostot financiare;
- g) miraton komisionet *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim si personel akademik sipas përcaktimeve në këtë statut dhe i përcjell Rektorit klasifikimin e kandidatëve;
- h) miraton kriteret dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të studentëve sipas propozimeve të departamenteve për të gjitha programet e studimeve;
- i) miraton studentët fitues të konkurseve të pranimit, të përzgjedhur nga komisionet përkatëse dhe i publikon ato;
- j) nënshkruan diplomatat dhe suplementet e tyre për të gjitha ciklet e studimeve që ofron Fakulteti, pa të drejtë delegimi të firmës;
- k) paraqet tek administratori i UART kërkesat për përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare;
- l) mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe artistike-kërkimore-shkencore në përputhje me planin e miratuar, ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies, procesit artistik, kërkimin shkencor, zbatimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punës, si dhe çdo detyrim tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit që ai drejton;
- m) mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore vjetore, si edhe respektimin e disiplinës në punë të personelit të njësisë kryesore;
- n) ngre grupe pune midis departamenteve për plotësimin e nevojave në nivel njësie kryesore;
- o) jep masa disiplinore për personelin akademik dhe ndihmës-akademik sipas përcaktimeve në këtë Statut, si dhe i propozon autoritetit kompetent marrjen e masës disiplinore të largimit nga detyra;
- p) vendos mbi ndërprerjen e studimeve ose pezullimin e studentëve në çdo cikël studimi, në raste të parashikuara në këtë Statut dhe në Rregulloren e brendshme të fakultetit;
- q) nënshkruan marrëveshje akademike me njësi të tjera kryesore vendase ose të huaja, që synojnë bashkëpunim reciprok, shkëmbime personeli akademik dhe studentësh, organizime të përbashkëta në nivel njësie kryesore dhe kualifikimi të mëtejshëm, si dhe për kryerjen e shërbimeve në favor të të tretëve;
- r) nxjerr urdhra dhe udhëzime për organizimin dhe funksionimin e njësive bazë dhe strukturave të tjera përbërëse të njësisë kryesore në ushtrim të detyrave të tyre;
- s) miraton transferimin e studentëve;
- t) miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti si dhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e UART, sipas propozimeve të departamenteve;
- u) përcjell në Rektorat për miratim në Senatin akademik, draft-propozimet të njësive bazë të miratuara në Dekanat, të:
 - I. Kufirit maksimal të pikëve për konkurset e pranimit në programet e studimit në fakultetet për secilin program studimi.
 - II. Kufirit minimal të pikëve të pranimit për në konkurset e pranimit në programet e studimit në fakultetet për secilin program studimi.
 - III. Ndarjes së pikëve në përqindje në dy zëra si më poshtë:
 - a. Përqindjen e notës mesatare të viteve të shkollimit dhe provimet e Maturës Shtetërore;
 - b. Përqindjen e pikëve të rezultateve të konkursit të pranimit;
 - IV. Formulës së llogaritjes të pikëve të konkursit të pranimit të njësisë kryesore për secilin program studimi.



- V. Propozimit për miratimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakulteti që drejton, për secilin program studimi.
- VI. Propozimit për miratimin paraprak të tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit për secilin program studimi.
- VII. Propozimit për përcaktimin e vlerës monetare të studimit, për ndjekjen e secilit program studimi si dhe për program të dytë për secilin program që ofron.
- VIII. Propozimit për përcaktimin e vlerës monetare të studimit, për ndjekjen e secilit program studimi që ofron.
 - v) ushtron kompetenca të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe akte të tjera të Universitetit të Arteve dhe të fakultetit që ai drejton.
- 3. Dekani në ushtrim të funksioneve të tij shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.
- 4. Funksione të tjera të Dekanit përcaktohen në Rregulloren e UART dhe në atë të njësisë kryesore, të miratuara nga Senati Akademik.

Neni 41 Zëvendësdekani

- 1. Zëvendësdekani është anëtar i personelit akademik me kohë të plotë, i cili plotëson këto kushte:
 - a) Të ketë përvojë në mësimdhënie ose kërkimin artistik/shkencor jo më pak se 5 vjet në IAL;
 - b) Të jetë personel akademik i brendshëm në Universitetin e Arteve prej jo më pak se 5 vjet pa shkëputje;
 - c) Të ketë të paktën gradën shkencore “Doktor”;
 - d) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - e) Të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
 - f) Të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- 2. Zëvendësdekani mund të caktohet për të ndjekur dhe mbikëqyrur secilin prej programeve të studimit, si edhe kërkimin artistik/shkencor.
- 3. Zëvendësdekani ndihmon Dekanin në realizimin e veprimtarisë së njësisë kryesore dhe mund të ushtrojnë dhe detyra të tjera bazuar në urdhrin e tij.
- 4. Në rast mungese, Dekani autorizon Zëvendësdekanin në ushtrimin e detyrave të tij, me përjashtim të rastit kur në këtë statut përcaktohet ndryshe.
- 5. Funksione të tjera të Zëvendësdekanit përcaktohen në Rregulloren e njësisë kryesore, të miratuar nga Senati Akademik.

Neni 42 Dekanati

- 1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga:
 - a) Dekani;
 - b) Zëvendësdekani;
 - c) Drejtuesit e njësive bazë;
- 3. Në mbledhjen e dekanatit mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë sipas nevojës.
- 4. Mënyra e thirrjes, funksionimit dhe organizimit të dekanatit zhvillohet në përputhje me Rregulloren e njësisë kryesore, të miratuar nga Senati Akademik.



5. Dekanati ushtron këto kompetenca:

- a) miraton planin strategjik të zhvillimit të fakultetit, sipas propozimit të Njësive Bazë të cilin më pas ia paraqet rektoratit;
- b) shqyrton analizën vjetore të veprimtarisë mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore të njësive bazë dhe harton analizën vjetore të njësisë kryesore;
- c) propozon projektbuxhetin e njësisë kryesore;
- d) miraton veprimtaritë e njësive bazë dhe i orienton ato gjatë ushtrimit të detyrave të tyre;
- e) miraton listën e periodikëve shkencorë ku do të pajtohet fakulteti, si edhe titujt e librave që do të blihen për bibliotekën e UART, sipas propozimeve të strukturave përbërëse;
- f) Dekanati jep mendime këshillimore për çdo tematikë apo problematikë që prek funksionimin akademik dhe administrativ të fakultetit;
- g) për çdo mbledhje të Dekanatit mbahet procesverbal;
- h) Dekanati shprehet me vendime dhe udhëzime për çështjet që merren në shqyrtim;
- i) Dekanati ushtron funksione të tjera të parashikuara në këtë statut dhe në Rregulloren e njësisë kryesore, të miratuar nga Senati Akademik.

Neni 43

Drejtuesi i njësisë bazë Departamenti

1. Drejtuesi i njësisë bazë/departamentit koordinon veprimtarinë dhe drejton punën e njësisë, e përfaqëson atë duke u mbështetur në vendimmarrjet e njësisë sipas detyrimeve ligjore dhe atyre të parashikuara në këtë Statut. Ai zgjidhet nga personeli akademik sipas përcaktimeve ligjore dhe duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:


- a) duhet të jenë personel akademik i kategorisë “Profesor” ose të ketë gradën “Doktor” PhD të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të BE-së ose të OECD-së. Në mungesë të kandidaturave me këtë titull/gradë dhe për efekt të përfaqësimit, mund të kandidojë edhe personeli akademik me kohë të plotë me gradën “Doktor” të fituar në Shqipëri.
- b) duhet të ketë përvojë në mësimdhënie për një periudhë jo më pak se 5 vjet dhe të jetë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
- c) të ketë veprimtari të spikatur akademike, artistike, kërkimore e shkencore të vazhdueshme dhe të gëzojë reputacion të lartë në publik;
- d) të mos jetë dënuar me një vendim të formës së prerë për vepra penale;
- e) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- f) të mos ketë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve” dhe ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Neni 44

Funksionet e Drejtuesit të Departamentit

1. Drejtuesi i Departamentit ushtron këto funksione:

- a) drejton dhe përfaqëson departamentin;
- b) drejton e kontrollon të gjithë punën mësimore, artistike e shkencore në departament;
- c) është përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së njësisë dhe përmbushjen e detyrave të saj;
- d) kontrollon plotësimin e dokumentacionit mësimor, regjistrat dhe çdo dokument që i shërben mësimdhënies, etj.;
- e) dokumentacionin mësimor e ruan dhe e dorëzon në protokollin pranë rektoratit, sipas rregullave dhe legjislacionin për arkivat në RSH;



- f) lidh marrëveshjen për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe rregulloreve ose akteve të tjera të miratuara në UART.
 - g) përcakton dhe mbikëqyr shpërndarjen e ngarkesës mësimore të anëtarëve të njësisë sipas drejtimeve të përcaktuara nga njësia dhe sigurohet për përmbushjen e saj;
 - h) mbikëqyr veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore në departament në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktivitetit artistik-kërkimor-shkencor e akademik të personelit akademik të departamentit;
 - i) mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar dhe të kërkimeve artistike-shkencore dhe veprimtarive të tjera;
 - j) mbikëqyr paraqitjen dhe disiplinën në punë të anëtarëve të njësisë duke u siguruar për mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrimeve dhe njëkohësisht të të drejtave të anëtarëve të njësisë bazë;
 - k) paraqet në dekanat kërkesat me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare të njësisë bazë;
 - l) evidenton, verifikon dhe, kur është rasti, i propozon dekanatit masat për shkeljet e disiplinës në punë nga punonjësit e departamentit sipas përcaktimeve në Statut;
 - m) miraton mënyrën e vlerësimit të studentëve dhe ngrre komisionet e provimeve në lëndët që mbulon departamenti;
 - n) jep miratimin paraprak për angazhimin e personelit në një tjetër institucion të arsimit të lartë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
 - o) propozon largimin nga detyra të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, për shkelje të rënda dhe të përsëritura dhe marrjen e masave të tjera disiplinore;
 - p) ushtron detyra të tjera të përcaktuara në këtë statut, në rregulloren e Universitetit të Arteve, rregulloren e fakultetit dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Në përmbushje të detyrave sa më sipër, autoriteti drejtues i njësisë bazë zhvillon analiza periodike të punës, mësimdhënies, projekteve artistike, kërkimit shkencor dhe për raste të tjera të veçanta që mund të dalin.
 3. Përgjegjësi i Departamentit në ushtrim të funksioneve të tij shprehet sipas rastit me vendime, urdhra dhe udhëzime.

Neni 45

Përfundimi i mandatit të autoriteteve të zgjedhura dhe të anëtarëve të Komisioneve

1. Mandati i autoriteteve të zgjedhura, anëtarëve të Komisioneve dhe të Këshillit të Etikës përfundon:
 - a) me mbarimin e afatit;
 - b) me dorëheqje;
 - c) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UART;
 - d) kur mungon pa arsye në 6 seanca radhazi mbledhjesh të tij;
 - e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - f) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - g) në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - h) kur mbush moshën e pensionit;
2. Rregullime të tjera përcaktohen në Rregulloren e Universitetit të Arteve.

KREU IV ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Neni 46



Struktura administrative e Universitetit të Arteve

Struktura administrative e Universitetit të Arteve konsiderohet:

- a) Bordi i Administrimit;
- b) Administratori i Universitetit të Arteve;
- c) Struktura e auditimit të brendshëm;
- d) Struktura ekonomike;
- e) Struktura e investimeve;
- f) Struktura e prokurimeve;
- g) Struktura e shërbimeve.

Neni 47

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit është organ kolegjal i cili ka kompetenca vendimmarrëse, mbikëqyrëse dhe kontrolluese në veprimtaritë e Universitetit të Arteve në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, në funksion të përmbushjes së misionit të UART. Ai është organi më i lartë drejtues, ekzekutiv i UART, në fushën administrative.
2. Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme. Përbërja e tij përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të UART, të miratuar nga Bordi i Administrimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
3. Niveli i kontributit financiar të Ministrisë që mbulon Arsimin, të qeverisjes vendore dhe të vetë UART bazohet në planin buxhetor afatmesëm të Universitetit, me marrëveshje midis tyre. Ky plan përditësohet çdo vit dhe në fund të vitit të tretë financiar bëhet rivlerësimi i financimit dhe përcaktimi i pjesëmarrjes së kontribuesve në Bordin e Administrimit.
4. Anëtarët, përfaqësues të UART, përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listës së anëtarëve të personelit akademik efektiv që vetëkandidohen ose propozohen nga njësitë kryesore të Universitetit.
5. Anëtarët përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike dhe emërohen nga Ministri dhe Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 48

Funksionet e Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit të UART ka këto funksione kryesore:
 - a) Garanton qëndrueshmërinë financiare të UART dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) Miraton paraprakisht Statutin e Universitetit të Arteve, para se t'i përcillet Senatit Akademik.
 - c) Me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të UART dhe mbikëqyr zbatimin e tij.
 - d) Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e UART, si dhe ndarjen ose bashkimin e UART dhe/ose të njërive përbërëse të UART, me një institucion tjetër të arsimit të lartë ose njësi të tjera përkatëse.
 - e) Jep mendim për projekt rregulloren e Universitetit të Arteve.
 - f) Miraton rregulloren për funksionimin e Bordit dhe ushtron funksionet e tij në bazë të saj.
 - g) Miraton kriteret shtesë që mund të propozojë Administratori për administrimin e burimeve financiare dhe materiale.
 - h) Miraton rregulloren financiare të Universitetit të Arteve në përputhje me Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe legjislacionin në fuqi.



- i) Përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron UART nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe për administrimin e të gjitha pasurive të UART.
 - j) Me propozim të Senatit Akademik, miraton me 2/3 e votave buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UART.
 - k) Miraton kriteret themelore për mirë planifikimin e fondeve dhe nevojave të UART në cilësi dhe në kohë, regjistrin e parashikimit të prokurimeve dhe ndryshimet e tij gjatë vitit financiar.
 - l) Mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit dhe monitoron zbatimin e buxhetit, duke vendosur edhe frekuencën e raportimit.
 - m) Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga Rektori.
 - n) Harton politika, miraton dhe monitoron strategjinë e menaxhimit të riskut dhe plan veprimin për arritjen e objektivave të UART;
 - o) Monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet Auditimit të Brendshëm.
 - p) Miraton kartën e auditimit të UART, planin strategjik dhe vjetor, programet e angazhimit dhe raportimet për çdo angazhim auditimi.
 - q) Siguron që Administratori të informohet dhe pajiset me raportet vjetore të auditimit të brendshëm të njësisë për mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e tij.
 - r) Shqyrton për miratim propozimin e Senatit për numrin e personelit për të gjitha nivelet.
 - s) Shqyrton për miratim propozimet e Administratorit për strukturën që mbështet veprimtarinë administrative e financiare dhe numrin e personelit administrativ.
 - t) Është përgjegjës për caktimin e procedurave për punësimin e administratorëve dhe të personelit administrativ, mbështetur në përcaktimet ligjore dhe në këtë Statut.
 - u) Emëron dhe shkarkon Administratorin e UART, me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.
 - v) Ngre komisione e grupe pune për çështje dhe veprimtari të veçanta me karakter administrativ dhe financiar.
 - w) Miraton kriteret e procedurave për punësimin, kategoritë dhe numrin e personelit administrativ në të gjitha nivelet si dhe nivelet e pagave të tyre sipas legjislacionit në fuqi.
 - x) Miraton, në përputhje me politikat e motivimit dhe shpërblimit në UART, shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të komisioneve të përhershme apo të përkohshme, anëtarëve të Senatit Akademik, trajtimin e veçantë financiar për personelin ndihmës-akademik dhe administrativ të vlerësuar shumë mirë sipas treguesve të vlerësimit të performancës në punë të zbatuar në UART si dhe shpërblime për punë të ndryshme, të zhvilluara jashtë funksionit të tyre nga ana e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të Universitetit të Arteve.
 - y) Miraton tarifën e studentëve për konkurset e pranimit, të regjistrimit si dhe tarifën vjetore të shkollimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.
 - z) Miraton listën e studentëve për bursa, përjashtime/reduktim të tarifave të shkollimit sipas VKM-ve në fuqi si dhe efektin financiar nga zbatimi i këtyre vendimeve.
 - aa) Kërkon organizim mbledhje dhe raportimi, duke njoftuar së paku 48 orë më përpara axhendën dhe vendin e mbledhjes, Administratorin e UART dhe çdo punonjës të lartë administrativ të UART për çdo problem të karakterit administrativ dhe financiar dhe kërkon sqarimet e nevojshme për të.
 - bb) Miraton fondet për pasurimin e Bibliotekave, si dhe për realizimin e projekteve të ndryshme artistike-kërkimore-shkencore.
2. Bordi zgjedh nga radhët e tij kryetarin dhe sekretarin me shumicë votash. Seancat e Bordit të Administrimit janë të mbyllura. Në rastet kur Bordi i Administrimit miraton propozime të Senatit Akademik apo Rektorit, ftohet për argumentim Rektori, drejtues apo ekspertë të ngarkuar prej tij.
 3. Veçori të tjera të funksionimit të Bordit të Administrimit përcaktohen në Rregulloren e



Bordit të Administrimit dhe në Rregulloren e Universitetit të Arteve.

Neni 49

Mbarimi i parakohshëm i mandatit për anëtarët e Bordit të Administrimit

1. Mandati i anëtarëve të Bordit të Administrimit mbaron para kohe:
 - a) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) kur anëtari i Bordit të Administrimit jep dorëheqjen;
 - c) kur kryen shkelje të rënda të ligjit;
 - d) në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - e) kur anëtari mungon pa arsye për tre seanca mbledhjesh, gjatë një viti akademik;
 - f) për shkak të ndryshimit të raporteve të përfaqësimit në Bordin e Administrimit;
 - g) kur vëren papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 10 034 datë 22.12.2008 *“Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”* dhe ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.
2. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Administrimit bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin.
3. Propozimi për shkarkim për anëtarët e Bordit të Administrimit që përfaqësojnë personelin akademik të UART bëhet nga Senati Akademik dhe miratohet nga ministri përgjegjës për arsimin.
4. Senati Akademik, në rastin e cenimit të interesave të UART, i propozon ministrit përgjegjës për arsimin, masa disiplinore apo shkarkim edhe për anëtarët e Bordit të Administrimit që përfaqësojnë ministrinë apo qeverisjen vendore.
5. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe të anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues.

Neni 50

Administratori i Universitetit të Arteve

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të UART, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet administrative dhe financiare.
2. Administratori përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret ligjore miratohet nga Senati Akademik dhe i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Administratori i UART, emërohet dhe shkarkohet, me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit të Administrimit.
4. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i shkencave” në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.
5. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
6. Administratori është anëtar i Rektoratit.
7. Administratori, raporton periodikisht dhe sa herë është e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij përpara Bordit të Administrimit. Përveç rasteve të parashikuara në këtë Statut dhe në legjislacion, në rastet e domosdoshme ose emergjente Administratori mund të kërkojë mbledhjen e Bordit të Administrimit dhe për këtë arsye njofton Bordin e Administrimit të paktën 48 orë përpara.
8. Administratori raporton për aspekte të aktivitetit të tij përpara Senatit Akademik kur këtë e kërkon Senati Akademik, apo vetë Administratori, në përputhje me kompetencat përkatëse.

Neni 51

Funksionet e administratorit



1. Administratori i UART, përveç sa është përcaktuar në ligj ushtron edhe këto funksione:
 - a. Zbaton të gjitha vendimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit me karakter financiar dhe administrativ, me përjashtim të atyre që haptazi vijnë në kundërshtim me ligjin.
 - b. Drejton personelin administrativ të UART për të koordinuar veprimtarinë e përditshme për përmbushjen e detyrave në mënyrë të tillë që formulimi dhe zbatimi i politikës së UART të jetë i mirë koordinuar dhe veprimtaria e stafit të përmbushet si duhet dhe në kohën e përcaktuar.
 - c. Administratori nënshkruan kontratat e punës me: strukturën e auditimit të brendshëm, strukturën ekonomike, strukturën e investimeve, strukturën e prokurimeve dhe strukturën e shërbimeve, në Universitetin e Arteve, të përcaktuara në nenin 46 të këtij Statuti.
 - d. Miraton planet vjetore të punës së njësive në varësi të tij/saj strukturore e funksionale dhe kontrollon realizimin e tyre.
 - e. Nxjerr urdhra dhe akte të tjera në funksion të drejtimit të veprimtarisë administrative e financiare brenda UART.
 - f. Ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor-Universiteti i Arteve, bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike. Gjatë ushtrimit të këtyre përgjegjësiave, urdhëron, kur është e nevojshme, të ngrihen grupet e punës për kryerjen e detyrave specifike me karakter teknik në secilin Fakultet, në ndihmë të njësisë përgjegjëse për prokurimet.
 - g. Koordinon punën për përgatitjen nga UART të programit buxhetor afatmesëm 3-vjeçar për Universitetin e Arteve. Harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të miratuar nga Rektori dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij.
 - h. Propozon në Bordin e Administrimit të UART ndryshimin e destinacionit të fondeve nga një njësi shpenzuese në një tjetër.
 - i. Miraton në BA të UART detajimin e fondeve buxhetore, të shpërndara për UART.
 - j. Shqyrton kërkesat dhe miraton në BA të UART rishpërndarjet brenda të njëjtit artikull buxhetor të shpenzimeve korrente dhe respekton limitet buxhetore të miratuara nga BA sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.
 - k. I paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit kalendarik.
 - l. Administratori mund të delegojë një ose disa nga detyrat e tij tek organet vartëse, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurave Administrative në RSH dhe legjislacioni në fuqi.
 - m. Siguron realizimin e kërkesave me karakter administrativ dhe financiar të Senatit Akademik dhe Rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.
 - n. I paraqet Bordit të Administrimit për miratim listën e studentëve për bursa, përjashtime/reduktim nga tarifat e shkollimit sipas VKM-ve në fuqi si dhe efektin financiar nga zbatimi i këtyre vendimeve.
 - o. Në bashkëpunim të ngushtë me strukturat akademike propozon studime për zhvillimin perspektiv të UART;
 - p. Në bashkëpunim të ngushtë me strukturat akademike dhe administrative merr pjesë në organizimin e studimit të tregut në lidhje me shërbimet ndaj të tretëve, që mund të ofrojnë njësitë bazë të UART;
 - q. Në bashkëpunim të ngushtë me strukturat akademike dhe administrative të Universitetit, dhe në përputhje me kriteret dhe objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të UART, harton dhe ndjek realizimin e një plani afatmesëm/afatgjatë me detyra të sakta e me afate kohore, për gjenerimin e të ardhurave alternative, duke synuar rritjen graduale të pavarësisë financiare, përmes rritjes së përqindjes së të ardhurave të Universitetit në



- totalin e buxhetit të tij.
2. Funksione të tjera të Administratorit përcaktohen në Rregulloren e UART dhe në akte të tjera të UART.

Neni 52

Njësi ndihmëse me karakter administrativ

1. Në varësi të administratorit funksionojnë dhe struktura ndihmëse me karakter administrativ, në nivel universiteti të cilat përbëhen nga personel administrativ. Ato përcaktohen nga aktet nënligjore në fuqi, si dhe nga ky statut.
2. Mënyra e funksionimit të strukturave të lartpërmendura përcaktohet në Rregulloren e Universitetit të Arteve.
3. Pranë çdo njësie kryesore funksionojnë struktura ndihmëse me karakter administrativ, të cilat përcaktohen në strukturën dhe në Rregulloren e çdo njësie kryesore.

KREU V

PERSONELI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Neni 53

Personeli i Universitetit

1. Personeli i Universitetit të Arteve përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik dhe personeli administrativ. Personeli mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.
2. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, rregulloren e UART si dhe në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe Universitetit të Arteve.
3. UART krijon për të gjithë personelin e tij kushte, mundësi dhe shanse të barabarta për zhvillimin e personalitetit, karrierës profesionale si dhe të kushteve të punës.

Neni 54

Statusi i personelit akademik

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, "*Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë*".
2. UART mund të kontribuojë në trajtimin financiar të personelit akademik, krahas përfitimeve nga Buxheti i Shtetit. Aspekte të trajtimit financiar si dhe përfitime të tjera për personelin akademik, përcaktohen nga Bordi i Administrimit, me propozim të Rektoratit.

Neni 55

Kategoritë e personelit akademik

1. Personeli akademik kryen veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit artistik dhe shkencor, shërbime për mbështetje dhe zhvillim të universitetit, këshillim për studentët, si dhe veprimtari të tjera.
2. Personeli akademik mund të jetë me drejtim mësimor dhe/ose kërkimor artistik/shkencor. Personeli akademik, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në:



- a) profesor;
 - b) lektor;
 - c) asistent-lektor.
3. Në kategorinë “Profesor” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar”. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
 - 3/1. Në Universitetin e Arteve, si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë me veprimtari në fushën e arteve, në zbatim të legjislacionit në fuqi jepen edhe titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte”.
 - 3/2. Anëtarët e personelit akademik që kanë fituar titullin akademik “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor”, dhe “Profesor i Asociuar në Arte”, ekuivalent me “Profesor i Asociuar”, do të gëzojnë të njëjtat të drejta si mbajtësit e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” vetëm për efekt të mësimdhënies dhe atë financiar, pa gëzuar të drejtën e të zgjedhurit apo emëruarit në pozicione që kërkojnë personel akademik nga kategoria “Profesor”, apo të caktimit si udhëheqës shkencor.
 - 3/3. Titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte” kanë vlefshmëri vetëm dhe për sa kohë mbajtësit e këtyre titujve janë personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve.
 4. Në kategorinë “Lektor” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore. Në këtë kategori përfshihen anëtarët e personelit akademik që mbajnë gradën shkencore “Doktor”, si dhe kanë së paku tre vite përvojë në mësimdhënie para ose pas fitimit të kësaj grade. Kjo kategori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar.
 5. Në kategorinë “Asistent-lektor” përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore-artistike-kërkimore-shkencore. Ata duhet të kenë së paku diplomën “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” ose një diplomë të ciklit 4-vjeçar. Asistent-lektori punësohet me kontratë me kohëzgjatje të caktuar.
 6. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë të paktën kualifikim të ciklit pasardhës. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
 7. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë të paktën kualifikim të ciklit pasardhës. Në UAR si një IAL me natyrë të veçantë, për lëndët e formimit artistik me propozim nga njësi bazë dhe me vendim të njësisë kryesore angazhohen në mësimdhënie edhe staf akademik me të njëjtin cikël studimi. Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik përcaktohet nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.
 8. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme për personelin akademik, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përcaktohen në kontratën individuale vjetore nga njësi bazë.

Neni 56

Punësimi i personelit akademik me kohë të plotë

1. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur përmes një procesi transparent, të paanshëm dhe objektiv.
2. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:
 - a) Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
 - b) Të zotërojnë formim universitar si dhe aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.



- c) Të kenë përfunduar studimet Master Shkencor/Master i Arteve dhe/ose doktoratë në të njëjtën fushë.
 - d) Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
 - e) Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
3. Njësia bazë, mbështetur në nevojat e saj, përcakton kritere të veçanta shtesë për vendet e punës, mbështetur mbi kategorinë e personelit që kërkohet të punësohet, të cilat miratohen nga Rektori. Kriteret e punësimit i përcillen Rektorit nga Drejtuesi i njësisë kryesore.
 4. Rektori i UART bën shpalljen përkatëse në faqet zyrtare të internetit. Përcaktimet mbi mënyrën e hartimit të kriteve dhe mënyra e shpalljes së vendeve të punës përcaktohen në Rregulloren e UART.
 5. Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni *ad hoc* përbëhet nga pesë anëtarë që i përkasin se paku kategorisë lektor:
 - a) 2 dy anëtarë përzgjidhen nga njësia bazë, në të cilën është shpallur procedura e konkurrimit;
 - b) 2 dy anëtarë përzgjidhen nga Drejtuesi i njësisë kryesore, ku së paku njëri prej tyre duhet të jetë anëtar i njësisë bazë, i cili ka shpallur procedurën e konkurrimit;
 - c) 1 një anëtar caktohet nga Rektori i Universitetit, me kërkesë të Drejtuesit të njësisë kryesore.
 6. Kryesues i Komisionit caktohet nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore.
 7. Komisioni, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendrike nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë:
 - a) vlerësimi i dosjes
 - b) intervista dhe mësimdhënia.
 Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës dhe mësimdhënies. Komisioni, brenda tri ditëve pune nga dita e zhvillimit të intervistës, shpall kandidatin/kandidatët fitues. Konkurrimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore ku edhe shpallen kandidatët fitues, shoqëruar dhe me publikimin në faqen zyrtare të njësisë kryesore.
 8. Komisioni *ad hoc* i paraqet kandidatin/kandidatët fitues Rektorit të UART përmes Drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori, brenda 10 ditëve nga shpallja e kandidatit/kandidatëve fitues, nëse nuk ka ankimime, nënshkruan kontratën e punës me të/ta. Efektet e marrëdhënieve të punës fillojnë nga data e përcaktuar në kontratën e punës me të/ta.

Neni 57

Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme

1. Njësitë kryesore me propozim të njësive bazë, të cilat përcaktojnë nevojat e tyre për personel akademik, i kërkojnë Rektorit miratimin e personelit akademik me kontratë të përkohshme. Rektori duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore, bazuar në planet mësimore të miratuara si dhe numrin e studentëve, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme.
2. Vendet e punës për personelin akademik fitohen me konkurrim sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Konkursi në UART drejtohet nga një komision "*ad-hoc*", i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse.
3. Kontrata e përkohshme nënshkruhet nga Rektori për një punë të caktuar ose për një periudhë kohë të caktuar.
4. Rregulla më të hollësishme për mënyrën e konkurrimit për personelin akademik me kontratë përcaktohen në Rregulloren e UART.
5. Personalitetet e fushës së Arteve, me propozim të njësive bazë dhe me kërkesë të Njësisë



kryesore, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të shoqëruar me një relacion bashkëlidhur propozimit për secilin anëtar të stafit akademik të propozuar nga kjo njësi, pasi miratohen në Senatin Akademik, Rektori i UART lidh kontratën e punës sipas vendeve të lira të miratuara.

6. Njoftimi për nevojën për personel akademik bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UART.

Neni 58

Personeli akademik i ftuar

1. Departamentet kanë të drejtë të ftojnë studiues e personalitete të artit dhe shkencës, vendas ose të huaj për qëllime akademike dhe artistike-kërkimore-shkencore që të kontribuojnë për periudha të shkurtra kohe.
2. Personeli akademik i ftuar përzgjidhet nga lista e personave që propozohen në departamentet përkatëse, duke pasur parasysh formimin akademik të tyre apo përvojën profesionale në një fushë të caktuar, që i shërben nevojave konkrete të mësimdhënies, veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor.
3. Personeli i ftuar propozohet nga Drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Drejtuesi i njësisë kryesore. Pas miratimit nga njësia kryesore miratohet përfundimisht në Senatin Akademik të UART.
4. Për personelin akademik të ftuar, të vlerësuar nga Komisioni *ad hoc* për Ekuivalentimin e Personelit Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” dhe të miratuar nga Senati Akademik, rektori i UART lidh kontratën e punës. Senati Akademik miraton kriteret për fitimin e titujve ekuivalent “Profesor në Arte”, që do të propozohen nga Dekanatet e Fakulteteve në UART për secilin program studimi që ato ofrojnë, si pjesë përbërëse e rregullores së Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik.

Neni 59

Kohëzgjatja e punës së personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” apo titullin ekuivalent “Profesor në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, ndërsa personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar” apo titullin ekuivalent “Profesor i Asociuar në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Personeli akademik i kategorisë lektor qëndron në detyrë deri në moshën e pensionit në përputhje me legjislacionin përkatës. Në të gjitha rastet, ndërprerja e detyrës bëhet jo më përpara se përfundimi i vitit akademik.
2. Mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e anëtarit të personelit akademik të kategorisë “Profesor”, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme.
3. Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës sipas pikës 2 të këtij neni mund të bëhet vetëm nëse realizohet njëri prej këtyre kushteve:
 - a) Kur largimi i anëtarit të personelit akademik, bën që të zbresë numri minimal i anëtarëve me tituj shkencorë që kërkohen për funksionimin e departamentit, sipas kërkesave ligjore.
 - b) Kur nuk ka anëtarë të tjerë të kategorisë “Profesor” në lëndën që anëtari i personelit akademik jep mësim apo në fushën artistike-kërkimore-shkencore ku pedagogu ushtron aktivitetin.
 - c) Kur vlerësohet kontributi i posaçëm i personelit akademik në fushën përkatëse.
4. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” mund të shkëputet përkohësisht nga UART, për



një periudhë deri në pesë vjet, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Në këtë rast, anëtari i personelit akademik, i drejton një kërkesë Rektorit. Për periudhën e shkëputjes personeli akademik mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtari i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm me të.

5. Personeli akademik mund të ndjekë kualifikime vetjake me karakter mësimor, artistik-kërkimor-shkencor. Në këto raste, ruhet vendi i punës në njësinë bazë. Nga ana e personelit duhet të plotësohet detyrimi që pas këtij kualifikimi të zhvillojë aktivitet mësimor, artistik-kërkimor-shkencor pranë njësisë bazë për një periudhë jo më pak se 5 vitesh.

Neni 60

Norma mësimore dhe mbingarkesa

1. Mësimdhënia është detyrim ligjor për të gjithë personelin akademik të UART. Ngarkesa e plotë për personelin akademik përcaktohet me Udhëzim të Ministrit përgjegjës për arsimin e lartë.
2. Personelit akademik i njihet e drejta e pagesës të orëve të realizuara mbi normën mësimore dhe e veprimtarive të tjera që lidhen me të, pasi të jetë justifikuar plotësimi i gjithë detyrimeve artistike, kërkimore dhe akademike të planifikuara në Planin vjetor dhe marrëveshjen vjetore të realizimit të kohës së punës të lidhur me Përgjegjësin e njësisë bazë.

Neni 61

Kontratat e punës për personelin akademik

1. Kontratat e punës, për të gjithë personelin akademik të UART, nënshkruhen nga Rektori, në përfundim të procedurave të punësimit të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo kontratë hartohet në tre kopje, ku një kopje i vihet në dispozicion punëmarrësit.
2. Personeli akademik i punësuar në Universitetin e Arteve dorëzon një dosje personale me të gjitha të dhënat pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila është objekt periodik i plotësimit të saj ndër vite. Format i dhe procedura e plotësimit të dosjes për personelin akademik të punësuar bëhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregulloreve të UART.

Neni 62

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik nga kategoria "Profesor" deri "Lektor" me miratim të njësisë bazë ku zhvillon veprimtarinë akademike, ka të drejtë të shkëputet nga angazhimet në UART, një herë në shtatë vjet, për periudha kohe deri në një vit, për të punuar për përparimin e tij akademik.
2. Për të përfituar nga parashikimi i pikës 1, anëtari i personelit akademik duhet të paraqesë në departament kërkesën e tij të shoqëruar me propozimin përkatës për kërkimin artistik/shkencor që do të realizojë, vendin ku do ta ushtrojë këtë kërkim, nëse ka, kohën e nevojshme që i duhet si edhe produktin që do të dorëzojë në fund të kësaj periudhe. Njësia Bazë shpreh miratimin e tij dhe njofton Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Rektorin e UART.
3. Në rast se anëtari i personelit akademik kërkon edhe mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, propozimi i kalon edhe Bordit të Administrimit për miratimin e pjesës financiare.
4. Kërkesa në çdo rast duhet që të paraqitet dy muaj përpara fillimit të vitit akademik sabatik.



5. Gjatë vitit akademik sabbatik, anëtari i personelit akademik paguhet me 100 për qind të pagës.
6. Mosrealizimi i kërkimit artistik/shkencor, sipas programit të miratuar përbën shkak për përgjegjësi disiplinore si dhe detyron të rimburojë të gjitha përfitimet financiare që ka marrë.
7. Mënyra e kontrollit të cilësisë së produktit që duhet të realizohet gjatë vitit sabbatik bëhet në përputhje me parashikimet e rregullores së njësisë kryesore, sipas marrëveshjes së nënshkruar me përgjegjësin e departamentit dhe të miratuar nga Drejtuesi i njësisë bazë.

Neni 63

Kontributi i personelit akademik

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:
 - a) mësimdhënie;
 - b) punë krijuese e artistike;
 - c) punë artistike-kërkimore-shkencore;
 - d) kontribut institucional;
 - e) kontribut profesional;
2. Organizimi i mësimdhënies realizohet çdo fillim viti akademik nga Njësia Bazë përkatëse.
3. Në çdo fillim viti personeli akademik me kohë të plotë nënshkruan pranë njësisë bazë ku është anëtar i saj, marrëveshjen paraprake e cila në fund të vitit akademik vlerësohet edhe njëherë po në njësinë bazë. Mos plotësimi i pikave të marrëveshjes vjetore të kohës të punës nuk i jep të drejtën e përfitimit të mbi normës personelit akademik me kohë të plotë. Përsëritja e mosplotësimit të marrëveshjes paraprake në dy vite të njëpasnjëshme nga ana e personelit akademik përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe rregulloreve të njësive kryesore në UART.
4. Angazhimi i personelit akademik në lëndët përkatëse përcaktohet me vendim nga njësia bazë.
5. Në caktimin e personelit akademik sipas lëndëve, Njësia Bazë duhet të marrë në konsideratë:
 - a) përvojën mësimore dhe artistike-kërkimore-shkencore në fushën përkatëse;
 - b) krijimtarinë artistike;
 - c) publikimet, aktivitetet shkencore të realizuara në fushën përkatëse;
 - d) gradën shkencore/titullin akademik që mban;
 - e) personeli akademik të mbulojë lëndë që janë brenda profilit të diplomës së tij/saj, specializimeve që mund të kenë apo mbështetur në eksperiencën e spikatur artistike të fushës, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
6. Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe realizimin e kontrollit të dijeve për lëndët individuale, grupet mësimore të studentëve që i përcaktohen në çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës.
7. Titullar i lëndës si rregull është anëtar i personelit akademik që ka titullin akademik ose gradën shkencore më të lartë. Në rast se ka dy apo më shumë anëtarë të personelit akademik që kanë të njëjtin titull/gradë shkencore, ata janë bashkë titullarë të lëndës. Kjo procedurë rregullohet në secilën njësi bazë sipas nevojave të tyre. Për lëndët karakterizuese (lëndët e formimit special artistik) ky rregull nuk mund të zbatohet. Në lëndët karakterizuese (lëndët e formimit special artistik) mund të kenë një ose disa titullarë.
8. Në rast se në lëndën përkatëse nuk ka personel akademik me titull akademik ose gradë shkencore, titullar i lëndës mund të jetë edhe njëri nga anëtarët e personelit akademik me profil të afërt me këtë lëndë. Në këtë rast titullar i lëndës mund të jetë edhe personeli akademik që i është ekuivalentuar veprimtaria artistike me gradën shkencore, sipas VKM përkatëse dhe procedurave të përcaktuara në këtë statut dhe rregulloren e UART.
9. Organizimi i punës artistike-kërkimore-shkencore realizohet në përputhje me planifikimin që secili departament bën në fillim të vitit akademik. Puna artistike-kërkimore-shkencore



realizohet nga të gjitha kategoritë e personelit akademik në përputhje me ndarjen që ka realizuar departamenti për këtë qëllim dhe drejtohet nga kategoria e personelit akademik “Profesor”. Departamenti, në organizimin e punës artistike, angazhon personel akademik mbajtës të titujve akademikë “Profesor i Asociuar në Arte” dhe “Profesor në Arte”.

10. Secili prej anëtarëve të personelit akademik ka detyrimin e vazhdueshëm të zhvillojë veprimtari-artistike-kërkimore-shkencore, në përputhje me detyrimet ligjore dhe planifikimin artistik dhe kërkimit shkencor.
11. Departamenti mund të krijojë grupe kërkimore artistike/shkencore. Titullar i këtij grupi do të caktohet pedagogu me titullin më të lartë akademik dhe në kushtet e barazisë së titujve, titullar do të jetë ai që ka më shumë vite përvojë kërkimore-krijuese e artistike në atë fushë. Titullari i grupit kërkimor artistik koordinon dhe drejton veprimtarinë artistike-kërkimore-shkencore në lëndën përkatëse, si dhe garanton respektimin e lirisë akademike të këtij personeli.
12. Departamentet kanë detyrimin që në çdo fillim viti akademik të përcaktojnë ndarjen e personelit akademik në personel me orientim mësimor dhe me orientim artistik-shkencor, në raport me nevojat e departamentit dhe me interesin e personelit akademik. Rregullime të mëtejshme përcaktohen në rregulloret e njësive kryesore.
13. Personeli akademik ka detyrimin të japë kontribut institucional nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, komisione apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe administrative në nivel njësie bazë, njësie kryesore apo në nivel institucioni, duke u liruar në këtë rast nga ngarkesa mësimore normale e parashikuar. Si rregull ky kontribut është i pagueshëm.
14. Kontributi profesional realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte apo forma të tjera të miratuara nga njësia bazë dhe ajo kryesore (udhëheqje diplomash ose doktoratash, pjesëmarrje në grupe pune me karakter artistik, kërkimor, profesional etj.).
15. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” si dhe ekuivalent me të/”Lektor” mund të gjenerojë (hartojë, aplikojë, zbatojë) projekte mësimore artistike, kërkimore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësive bazë ku bën pjesë dhe mbështetur në këtë Statut dhe gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
16. Personeli akademik me kohë të plotë ka të drejtë që të kryejë edhe veprimtari të tjera që nuk bien ndesh me statusin e tyre, me kushtin që të mos pengojë realizimin e detyrimeve ligjore ndaj UAR.
17. Rregullime të mëtejshme për mënyrën e realizimit të kontributit të personelit akademik, përcaktohen në Rregulloret e njësive kryesore.

Neni 64

Përgjegjësia disiplinore

1. Personeli akademik është përgjegjës për shkeljet e disiplinës në punë dhe mos përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në këtë Statut, Kodin e Etikës dhe rregulloret apo aktet e tjera të Universitetit të Arteve.
2. Raste që përbëjnë shkeljet përcaktohen në Rregulloren e Universitetit të Arteve të miratuara nga Senati Akademik, Kodin e Etikës si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 65

Procedimi disiplinor

1. Llojet e masave disiplinore janë si më poshtë:
 - a) tërheqje vëmendjeje;
 - b) vërejtje me paralajmërim;



- c) vërejtje me shkrim;
 - d) pezullim nga detyra;
 - e) largim nga detyra.
2. Pezullimi dhe largimi nga detyra është kompetencë vetëm e Rektorit të UART. Largimi nga detyra ndërmerret si masë vetëm pas përsëritjeve të njëpasnjëshme të shkeljeve. Konsiderohen shkelje të rënda veprimet apo mosveprimet e përsëritura të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të detyrueshme për zbatim gjatë kryerjes së detyrës. Konsiderohet shkelje e rëndë edhe kryerja e një vepre penale e cila dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Rastet e tjera të shkeljeve si dhe masat disiplinore që ndërmerren për to, përcaktohen në Kodin e Etikës dhe Rregulloren e UART.
 3. Masat disiplinore për personelin akademik procedohen nga Komisioni Disiplinor i njësisë kryesore, cili përbëhet nga:
 - a) Drejtuesi i njësisë kryesore;
 - b) Drejtuesi i njësisë bazë ku bën pjesë anëtari i personelit Akademik;
 - c) Nga zëvendësdekani.
 4. Komisioni Disiplinor pasi ka shqyrtuar rastin në fjalë, ja përcjell vendimin e marrë Personelit akademik ndaj të cilit është marrë masa, brenda pesë ditësh.
 5. Personeli akademik i proceduar ka të drejtë të ankimojë Vendimin për masën e marrë nga Komisioni Disiplinor tek Këshilli i Etikës, brenda pesë ditësh nga marrja e njoftimit për masën e marrë.
 6. Personeli akademik i proceduar ka të drejtë të ri ankimojë, vendim e marrë nga Këshilli i Etikës mbi vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor tek Senati Akademik, brenda pesë ditëve nga njoftimi i Këshillit të Etikës.
 7. Senati Akademik në rast ankimimi ngre një komision disiplinor *ad hoc*, i cili përbëhet nga pesë anëtarë të përzgjedhur, si vijon:
 - a) tre anëtarë të Senatit Akademik përzgjidhen përfaqësues të fakulteteve të ndryshëm nga fakulteti ku bën pjesë anëtari i personelit akademik që është i proceduar;
 - b) një anëtar i Senatit Akademik përzgjidhet përfaqësues nga fakulteti ku bën pjesë anëtari i personelit akademik i proceduar;
 - c) një anëtar përzgjidhet Juristi i UART.
 8. Komisioni disiplinor *ad hoc* i përcjell Senatit Akademik, brenda tridhjetë ditëve, një raport të detajuar. Senatit Akademik pasi merr në shqyrtim raportin merr vendimin përfundimtar.
 9. Personelit akademik i ndërpriten marrëdhëniet e punës kur nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në kontratë, kur shkel statutin dhe/ose rregulloren e UART, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Masat disiplinore dhe procedurat përcaktohen në Rregulloren e UART.

Neni 66

Mbarimi i Marrëdhënies së Punës

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës bëhet kur personeli akademik:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) mbush moshën e pensionit;
 - c) mbaron afatin e parashikuar në kontratën e punës;
 - d) bëhet i pa aftë për kryerjen e detyrave për shkaqe fizike dhe mendore;
 - e) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;
 - f) merr masën disiplinore të largimit nga puna;
 - g) raste të tjera të parashikuara nga ligji ose aktet nënligjore në fuqi.

Neni 67

Fitimi i titujve akademikë




1. Për fitimin e titullit “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Arteve aplikimi bëhet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për këtë procedurë si dhe mbështetur në rregulloren e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik të UART.
2. Aplikimi për fitimin e titullit “Profesor i asociuar në Arte”, ekuivalent me “Profesor i asociuar” dhe “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor”, nga personeli akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve, bëhet në zbatim të VKM-së nr. 145, dt. 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbështetur në kriteret e miratuara nga Senati Akademik.
3. Personeli akademik, i cili ka titullin “Profesor i asociuar në Arte”, aplikon për fitimin e titullit “Profesor në Arte”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit “Profesor i asociuar në Arte”/ “Profesor i Asociuar”.
4. Fitimi i titullit “Profesor i asociuar në Arte” dhe “Profesor në Arte” do të shoqërohet me efekte financiare sipas titullit akademik ekuivalent.
5. Veprimtaria e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik rregullohet përmes rregullores së tij të brendshme, e cila miratohet nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 68

Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik

1. Të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik përcaktohen në kontratën vetjake të punës, në Kodin e Punës, në Statut dhe në akte të brendshme të UART.
2. Të drejtat e personelit akademik janë si vijon:
 - a) Pedagogu ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mundësitë logjistike që ofron UART duke respektuar të gjitha rregullat e brendshme të UART.
 - b) Të kërkojë nga njësia bazë respektimin dhe zbatimin e të gjitha detyrimeve të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor, artistik-kërkimor-shkencor.
 - c) Të kërkojë nga organet drejtuese të njësisë kryesore dhe të Universitetit të Arteve respektimin e të drejtave të tij që burojnë nga Kodi i Punës dhe nga Ligji për Arsimin e Lartë si dhe akteve nënligjore në fuqi.
 - d) Të zbatojë vetë dhe të kërkojë nga të tjerët një frymë etiko-morale në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me Kodin e Etikës.
 - e) Të kërkojë respektimin e lirisë akademike.
 - f) Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
 - g) Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore-artistike-shkencore, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me profilin e tij/saj.
 - h) Të ushtrojë lirinë e shprehjes.
 - i) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e Universitetit të Arteve, duke kryer veprimtari zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret përkatëse të UART.
 - j) Të publikojë rezultatet e punës kërkimore-artistike dhe krijuese, brenda përcaktimeve që kanë të bëjnë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale.
 - k) Të marrë pjesë në veprimtari të mësimdhënies, kërkimit-artistik/shkencor si dhe shërbimeve në zhvillim të UART.
 - l) Të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit në funksion të promovimit të titullit /gradës shkencore.
 - m) Të përcaktojë lirisht metodat e procesit mësimor, në kuadër të programeve mësimore dhe në përputhje me politikat e UART.
 - n) Të ketë ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe politikat e brendshme të UART.



- o) Të përfitojë shpërblim për punën e kryer në bazë të kontributeve individuale.
 - p) T'i ruhet vendi i punës gjatë kohës që kryen punë kërkimore-artistike-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij.
 - q) Personeli akademik i kategorisë "Profesor", mund të kryejë detyra të larta në administratën publike për jo më shumë se 5 vjet pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij.
 - r) Të paraqesë ankesë pranë Këshillit të Etikës, nëse konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim jo etik ndaj tij.
 - s) Të përfitojë pushim vjetor jo më pak se 40 ditë pune.
3. Detyrimet e personelit akademik janë si vijon:
- a) Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën, kornizën ligjore në fuqi dhe aktet e tjera ligjore të UART.
 - b) Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit-artistik-shkencor, sipas orarit të punës dhe ta shfrytëzojë për kryerjen e detyrave të ngarkuara. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - c) Të rrisë aftësitë profesionale dhe akademike si edhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim.
 - d) Të hartojë programin mësimor të lëndës, ta plotësojë dhe ta përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme dhe ta dorëzojë atë në Njësinë Bazë përkatëse.
 - e) Të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar nga UART duke garantuar nivele të larta mësimdhënieje dhe në veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore.
 - f) Të përballojë ngarkesën mësimore të përcaktuar nga Njësia Bazë.
 - g) Të ndjekë sistematikisht zhvillimin dhe arritjet e artit dhe shkencës në fushën përkatëse në planin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe t'i pasqyrojë atë në procesin mësimor.
 - h) Të hartojë në kohën e duhur pyetjet e provimit duke i riformuluar dhe përditësuar ato çdo vit.
 - i) Të plotësojë me përgjegjësi regjistrin e pedagogut.
 - j) Të përcaktojë oraret e konsultimeve me studentët dhe t'i zhvillojë ato në përputhje me kalendarin e përcaktuar dhe të miratuar nga Njësia Bazë.
 - k) Të respektojë oraret e zhvillimit të procesit të rregullt mësimor.
 - l) Të zbatojë kohën vjetore të punës dhe mësimdhënies sipas aktmarrëveshjes së firmosur në Njësinë Bazë.
 - m) Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku është caktuar si anëtar.
 - n) Të ruajë bazën materiale që ka në ngarkim e në përdorim.
 - o) Të zbatojë urdhrat/vendimet e autoriteteve, organeve drejtuese lidhur me zhvillimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e provimeve.
 - p) Të jetë aktiv dhe të bashkëpunojë në aktivitetet artistike shkencore të organizuara nga Njësia Bazë.
 - q) Të zbatojë çdo urdhër të posaçëm të autoritetit drejtues përkatës, për situata të veçanta, emergjente, apo ngjarje të rëndësishme në Njësinë Kryesore dhe në UART.
 - r) Të mos lejojë apo kërkojë asnjë përfitim pasuror për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës si dhe shpërblimeve të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe Rregulloren e UART.
 - s) Të mbrojë interesat e ligjshme të institucionit, të ruajë të dhënat konfidenciale të UART në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe Rregulloren e UART.
 - t) Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në UART;
 - u) Të zbatojë etikën institucionale në respektim të kodit të UART dhe figurës profesionale gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë akademike.
4. Të drejta dhe detyrime të tjera të personelit akademik përcaktohen në përputhje me kuadrin



ligjor në fuqi si dhe Rregulloren e UART.

Neni 69


Kategoritë e personelit ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik/shkencor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët, teknikët.
3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, artistike dhe /ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UART në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.

Neni 70

Punësimi i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor-artistik-shkencor

1. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, mbështetur në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori i UART.
2. Personat kandidatë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:
 - a) të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë;
 - c) të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
 - d) të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
3. Në rastin kur personeli punësohet nga njësia bazë, Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin *ad hoc* për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni *ad hoc* përbëhet nga pesë anëtarë si vijon:
 - a) dy anëtarë përzgjidhen nga njësia bazë për të cilin është shpallur procedura e konkurrimit, mbi bazën e propozimit të këtij të fundit;
 - b) dy anëtarë përzgjidhen nga Drejtuesi i njësisë kryesore ku së paku njëri prej tyre duhet të jetë anëtar i njësisë bazë, e cila ka shpallur procedurën e konkurrimit;
 - c) një anëtar, caktohet nga Rektori i Universitetit, me kërkesë të Drejtuesit të njësisë kryesore.
4. Në rast se personeli ndihmës akademik kërkohet të punësohet nga njësia kryesore atëherë kriteret e veçanta të punësimit përcaktohen nga dekanati. Drejtuesi i Njësisë Kryesore ngre komisionin përkatës, i cili përbëhet nga katër anëtarë të përcaktuar nga dekanati dhe një anëtar i propozuar nga Rektori.
5. Në rastet e përcaktuara më lart, drejtuesi i njësisë kryesore i paraqet Rektorit renditjen e kandidatëve sipas vlerësimit të komisionit *ad hoc* dhe Rektori lidh kontratë pune me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur fitues nga Komisioni, mbështetur në legjislacionin në fuqi, brenda 10 ditëve nga shpallja e fituesve sipas përcaktimeve më lart.
6. Në rast se personeli ndihmës akademik do të punësohet pranë Rektoratit, atëherë kriteret e punësimit përcaktohen nga ky i fundit. Komisioni në këtë rast ngrihet nga Rektori dhe përbëhet nga pesë anëtarë të përcaktuar nga Rektorati. Kryetari i Komisionit i paraqet Rektorit renditjen e kandidatëve sipas pikëve të fituara nga komisioni *ad hoc* dhe Rektori lidh kontratë pune me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur fitues nga Komisioni, mbështetur në legjislacionin në fuqi, brenda 10 ditëve nga shpallja e fituesve sipas përcaktimeve më lart.



7. Rregullat për shpalljen e vendit të punës, mënyra e zhvillimit të konkursit të pranimit si dhe veçori të tjera për punësimin e personelit ndihmës akademik përcaktohen në Rregulloren e Institucionit.

Neni 71

Personeli administrativ

1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të UART sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Struktura e brendshme akademike dhe administrative në UART organizohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, propozohet nga Senati Akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit.
3. Punësimi i Personelit administrativ bëhet me konkurs publik. Kriteret e përgjithshme të punësimit janë si më poshtë:
 - a) të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të ketë arsimin përkatës si dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë;
 - c) të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
 - d) të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
4. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit administrativ dhe procedura e punësimit përcaktohen nga Rektori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
5. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit administrativ në njësitë kryesore përcaktohen nga dekanati dhe miratohen nga Bordi i Administrimit.
6. Punësimi i personelit administrativ në UART bëhet me konkurs publik.
7. Konkursi i punësimit të personelit administrativ në UART drejtohet nga një komision *ad hoc*, me përbërje sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse për këtë kategori.
8. Procedurat për përzgjedhjen e kandidatit fitues i referohen procedurave të punësimit të miratuara nga Bordi i Administrimit i UART.
9. Të drejtat dhe detyrimet e personelit administrativ, përcaktohen në Rregulloren përkatëse të njësisë ndihmëse për çështje ekonomiko-financiare dhe administrative, si dhe në kontratën individuale të punës, që nënshkruhet nga Rektori i UART.

Neni 72

Kontratat e punës për personelin akademik, ndihmës akademik me karakter akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ

1. Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik, ndihmës akademik me karakter akademik dhe ndihmës akademik me karakter administrativ, të përcaktuara në nenin 37 të këtij Statuti.
2. Kontrata e punës duhet të përmbajë të gjithë elementët e përcaktuara në Kodin e Punës dhe në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 73

Konflikti i Interesave

1. Personeli akademik dhe punonjësit e tjerë të Universitetit të Arteve si dhe të emëruarit personel i jashtëm duhet të njohin rastet ligjore të konfliktit të interesit dhe të deklarojnë paraprakisht në organin që i emëron ose i zgjedh.
2. Gjatë ushtrimit të funksionit ose të detyrës duhet të parandalohen raporte të tilla.



Procedimi disiplinor i personelit ndihmës akademik dhe administrativ

1. Personeli ndihmës akademik dhe administrativ i nënshtrohet procedurave disiplinore në rast të shkeljeve të detyrimeve të tij të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Shkeljet e personelit ndihmës akademik dhe administrativ, klasifikohen në shkelje të rënda dhe shkelje të lehta.
3. Konsiderohen si shkelje të rënda:
 - a) mos përmbushja detyrimeve sipas kontratës së lidhur për pozicionin e punës;
 - b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave;
 - c) mosparaqitja në punë për më shumë se një javë pune, pa shkaqe të justifikuara;
 - d) dëmtimi dhe/ose keqpërdorimi i rëndë i pasurisë/pronës së Universitetit të Arteve;
 - e) përdorimi i aseteve të Universitetit të Arteve për qëllime përfitimi dhe pa njoftim të organeve në varësi;
 - f) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale në vlerë të lartë, të cilat jepen për shkak të detyrës;
 - g) çdo shkelje e lehtë e përsëritur.
4. Janë shkelje të lehta:
 - a) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;
 - b) shkelja e rregullave të etikës;
 - c) kryerja brenda ose jashtë orarit zyrtar e veprimeve që cenojnë figurën e personelit të Universitetit të Arteve.
5. Për personelin ndihmës akademik dhe për personelin administrativ, në varësi të rastit, ngritja e Komisionit Disiplinor bëhet nga struktura pranë së cilës ai është emëruar.
6. Në rast se personeli ndihmës akademik është emëruar pranë departamentit, atëherë ky i fundit ngre komisionin disiplinor të përbërë nga tre anëtarë që zgjidhen nga radhët e tij.
7. Në rast se personeli ndihmës akademik është emëruar pranë Fakultetit, atëherë ky i fundit ngre komisionin disiplinor të përbërë nga tre anëtarë si më poshtë:
 - a) një anëtar është dekani;
 - b) një anëtar është zëvendësdekani i caktuar nga dekani;
 - c) një anëtar përcaktohet nga Administratori i UART.
8. Në rast se personeli ndihmës akademik është emëruar në nivel Institucional, atëherë, komisioni disiplinor ngrihet nga Rektori dhe përbëhet nga tre anëtarë si më poshtë:
 - a) një anëtar është njëri nga zëvendësrektorët i caktuar nga rektori;
 - b) një anëtar është njëri prej drejtuesve të strukturave ndihmës akademike të UART;
 - c) një anëtar është Administratori i Universitetit të Arteve.
9. Në rastin e shkeljeve të lehta, Komisioni ka të drejtë të japë masën disiplinore, “Vërejtje me paralajmërim”.
10. Në rast se në përfundim të procedurave konstatohet shkelje e rëndë dhe e përsëritur atëherë, organi procedues, në varësi të llojit të personelit, i kërkon Rektorit zgjidhjen e kontratës së punës, i cili vepron në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VI

RRJETI KOMPJUTERIK DHE INTERNETI, FAQJA ZYRTARE WEB DHE RRJETET SOCIALE, POSTA ELEKTRONIKE, SISTEMI I MENAXHIMIT TË STUDIMEVE DHE KURRIKULËS, SISTEMET E BIBLIOTEKËS SHKENCORE, SISTEMI I MONITORIMIT ME VIDEO-MBIKËQYRJE DHE SHËRBIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN



Neni 75

Rrjeti kompjuterik dhe interneti

1. Universiteti i Arteve nëpërmjet njësive përgjegjëse, administron infrastrukturën informatike ku përfshihen të gjitha postet e punës, laboratorët, lektoriumet, ambientet e performancave, etj., të pajisura me rrjet kabllor dhe me valë, në shërbim të proceseve akademike.
2. Njëkohësisht, Universiteti i Arteve nëpërmjet njësive përgjegjëse administron shërbimin e internetit në Institucion, të mundësuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH).
3. Rregulloret përkatëse të Universitetit të Arteve përcaktojnë rregulla më të detajuara mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike dhe përdorimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit si dhe mbi përdorimin e shërbimit të internetit.

Neni 76

Faqja zyrtare web dhe rrjetet sociale

1. Universiteti i Arteve nëpërmjet njësive përgjegjëse, administron, përditëson me informacion dhe mirëmban faqen zyrtare web.
2. Në faqen zyrtare web të Universitetit të Arteve duhet të gjejnë pasqyrim:
 - a) të dhëna për anëtarët e organeve kolegjinale dhe drejtuesit e Universitetit të Arteve si edhe jetëshkrimet e tyre;
 - b) të dhëna për drejtuesit e aparatit administrativ të Rektoratit dhe jetëshkrimet e tyre;
 - c) ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë;
 - d) kopje elektronike të Statutit, rregullores së Universitetit të Arteve, rregulloreve të organeve të tjera kolegjinale drejtuese të UART si dhe çdo rregullore tjetër që përdoret nga aparati administrativ i rektoratit të Universitetit të Arteve;
 - e) kopje të çdo marrëveshjeje të lidhur nga Universiteti i Arteve apo njësitë e tij;
 - f) çdo vendimmarrje dhe aktivitet që realizohet nga organet drejtuese të Universitetit të Arteve;
 - g) çdo e dhënë, informacion apo akt tjetër i Universitetit të Arteve që çmohet i nevojshëm;
 - h) të dhëna formularë, rregullore, vendime dhe çdo material tjetër që ka të bëjë me zgjedhjet për autoritetet drejtuese në UART;
 - i) të dhëna mbi rrjetin Alumni të UART.
3. Në faqen zyrtare web të njësive kryesore duhet të gjejnë pasqyrim:
 - a) të dhënat për drejtuesit e njësisë kryesore dhe jetëshkrimet e tyre;
 - b) të dhënat për personelin akademik të njësisë kryesore dhe jetëshkrimet e tyre;
 - c) ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë;
 - d) kopje elektronike të Statutit, rregullores së njësisë kryesore, si edhe të çdo rregulloreje tjetër që përdoret nga aparati administrativ i njësisë kryesore;
 - e) kopje të çdo marrëveshjeje në të cilën njësia kryesore është përfituese;
 - f) çdo aktivitet që realizohet nga njësia kryesore;
 - g) çdo e dhënë tjetër, informacion, vendim, data provimesh, kritere konkurrimesh pranimi me rregulloret përkatëse, etj., që çmohen të nevojshme;
 - h) të dhëna për veprimtarinë mësimore: strukturën akademike, orarin mësimor, sesionet e provimeve etj.;
 - i) të dhëna për planet mësimore të cikleve të studimit Bachelor, Master dhe Doktoratë, të miratuara për secilin vit akademik nga Senati Akademik;



- j) të dhëna për veprimtaritë artistike dhe kërkimore, postera, fletë palosje ose materiale të tjera mbi aktivitetet artistike, buletine, botimet shkencore, publikime, kumtesa, monografi, raporte etj.;
 - k) të dhëna dhe njoftime për projektet me karakter mësimor-artistik-shkencor;
 - l) të dhëna për sallat e performancave, galerinë FAB, lektoriumet, atelierët, laboratorët dhe ambientet që ofrojnë etj.;
 - m) informacione për konferenca studimore shkencore, praktika profesionale, shkolla verore, takime të hapura, leksione të hapura, Master classe etj..
4. Faqet zyrtare të UART të administruara nga Rektorati, përditësohen me informacion për të pasqyruar në kohë reale aktivitetet që zhvillohen dhe informacione plotësuese, njoftime, publikime, etj., nëpërmjet rrjeteve sociale si Facebook, Google, LinkedIn, YouTube, Instagram, etj., duke synuar të jetë sa më pranë anëtarëve të Universitetit dhe publikut.

Neni 77

Posta elektronike zyrtare e UART

1. Me qëllim sigurimin e komunikimit zyrtar, ndërmjet organeve drejtuese të çdo niveli, ndërmjet personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, Universiteti nëpërmjet njësive përgjegjëse administron dhe mirëmban postën elektronike.
2. Në zbatim të kësaj dispozite, secili anëtar i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, pajiset me një adresë të tillë.
3. Komunikimi elektronik në UART, bëhet vetëm nëpërmjet postës zyrtare elektronike.
4. Përdorimi i postës zyrtare elektronike në çdo rast duhet të respektojë kërkesat e legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Rregullorja përkatëse e Universitetit të Arteve përcakton rregulla më të detajuara, për përdorimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Neni 78


Sistemi i menaxhimit të studimeve dhe kurrikulës

1. Universiteti nëpërmjet njësive përgjegjëse administron dhe përditëson me informacion sistemin elektronik të menaxhimit të studimeve dhe kurrikulës ESSE3 në bashkëpunim dhe në koordinim me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH).
2. Nëpërmjet këtij sistemi administrohen procese të rëndësishme si: Regjistrimi i studentëve; Pranimet dhe konkurset; Matrikulimet; Konfirmim diplomash; Regjistrime vjetore; Ndërrim programi studimi; Transferime në hyrje; Transferime në dalje; Pezullim karriere; Mbyllje dhe riaktivizim karriere; Plani mësimor; Kurrikula; Grafiku i provimeve; Prenotim masiv i studentëve në provim; Syllabuseve; Procesverbalet online; Hedhja e notave nga pedagogët dhe gjenerimi i procesverbaleve; Fshirja e lëndëve nga librezat; Plani mësimor dhe librezat; Zgjedhja e lëndëve me zgjedhje nga faqja web; Prenotim në provime; Përcaktim grupesh; Verbalizim provimesh; Rinjehsim dhe njohje provimesh; Menaxhim përdoruesi; Evidenca të dhënash; Akte karriere; Administrim sistemi; etj., ku në çdo rast respektohen kërkesat e legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 79

Sistemet e Bibliotekës Shkencore

1. Biblioteka Shkencore, administron dhe plotëson me informacion dy sistemet e saj, Sistemin e Integruar të Menaxhimit dhe Sistemin e Arkivit Digjital.



2. Nëpërmjet Sistemit të Integruar të Menaxhimit kryhet administrimi i automatizuar i burimeve fizike dhe financiare nëpërmjet moduleve të qarkullimit, pasurimit, katalogimit, serialeve (periodikut) dhe ndërfaqes së kërkimit dhe aksesit publik (OPAC), duke mundësuar cilësi, shpejtësi dhe efektivitet në shërbimet e ofruara ndaj anëtarit të Bibliotekës dhe publikut.
3. Nëpërmjet Sistemit të Arkivit Digjital kryhet ruajtja e materialeve të formateve të shkruara, skanuara si dhe audio-vizuale, në shërbim të proceseve akademike të Universitetit. Ruajtja e fondeve arkivore dhe mundësimi i aksesimit të tyre në format elektronik synon të mënjanojë humbjen e pa-rekuperueshme, duke i ruajtur elektronikisht dhe shmangur kontaktin direkt të përdoruesit me materialet fizike të konsumuara nga përdorimi dhe koha, synon të lehtësojë aksesin në shërbim të studimit akademik, synon të ruajë trashëgiminë kulturore kombëtare dhe të nxisë promovimin e dijeve dhe kulturës në plan ndërkombëtar, duke marrë pjesë në shkëmbimin e ndërsjelle të burimeve elektronike me biblioteka të huaja.
4. Rregullorja përkatëse përcakton rregulla më të detajuara, për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve.

Neni 80

Sistemi i monitorimit me video-mbikëqyrje

1. Universiteti i Arteve nëpërmjet njësive përgjegjëse, administron sistemin e monitorimit me video-mbikëqyrje të kampusit universitar, në ambiente të jashtme dhe të brendshme, me kamera me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë regjistrimet në NRV/Server deri në 2 muaj, në përputhje me udhëzimin nr. 134, datë 10.3.2017, në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.
2. Nëpërmjet sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje monitorohen godinat e Universitetit, shesh-pushimi i automjeteve, rrugëkalimet dhe shesh-pushimet kryesore të jashtme, rrugëkalimet e brendshme, si dhe ambientet e rëndësisë së veçantë (dhoma e serverëve), për të siguruar mbrojtjen e pronës dhe kontrollin mbi rrugëkalimet kryesore dhe hyrje/daljet e Universitetit.
3. Zbatimi i masave teknike për fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale të siguruara përmes sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje, bazohet në rregulloren përkatëse të miratuar në Senatin Akademik dhe duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 81

Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, pranë Universitetit të Arteve, në vijim shërbimi i MZSH-së i UART, funksionon sipas ligjit nr. 152, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, pronës, mjedisit, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Misioni i këtij shërbimi si dhe veprimtaria e tij në UART bazohet në rregulloren e posaçme për këtë strukturë të miratuar nga Senati Akademik, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU VII ORGANIZIMI I STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE



Neni 82
Studimet universitare

1. Në përputhje me parashikimet ligjore, forma e studimit që ofrohen nga njësitet kryesore të Universitetit të Arteve është më kohë të plotë. Forma të tjera studimi mund të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Aplikimi dhe zbatimi i formave të tjera të studimit bëhet me miratim të ministrit përgjegjës.
3. Mësimi në UART ofrohet në gjuhën shqipe.

Neni 83
Organizimi i studimeve universitare

1. Programet e studimeve në Universitetin e Arteve organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme:
 - a) cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor”;
 - b) cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”/ “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”;
 - c) cikli i tretë i studimeve “Doktoraturë”.
2. Universiteti i Arteve ofron programe të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
3. Në Universitetin e Arteve, programet e studimeve hartohen nga njësitet bazë dhe përcillen për diskutim dhe shqyrtim në Rektorat pranë zyrës së Zëvendësrektorit për anën mësimore dhe sektorit të kurrikulës dhe më pas përcillen për miratim Senatit Akademik të UART.
4. Rektorati ka përgjegjësinë që programet e studimeve që ofron Universiteti i Arteve, të shpallen publikisht para fillimit të aplikimeve për pranime në to.
5. Programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, janë programe të studimeve universitare.
6. Universiteti i Arteve në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ka të drejtë të ofrojë edhe programe të studimeve profesionale, pas arsimit të mesëm, me jo më pak se 120 kredite. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve duhet të jetë jo më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer. Kreditet e akumuluar të studimeve profesionale të vërtetuara, mund të transferohen në studime universitare të ciklit të parë, që ofrohen në UART në fusha të njëjta ose të përafërta në përputhje me kriteret që vendos Senati Akademik i UART.

Neni 84
Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet në Universitetin e Arteve zhvillohen me bazë vitin akademik. Shpallja e datës së fillimit të vitit akademik dhe e përfundimit të tij bëhet sipas akteve nënligjore nga ministria përgjegjëse për arsim.
2. Viti akademik organizohet në 30 javë dhe 2 semestra. Ngarkesa mësimore në auditor ndahet në lëndë individuale artistike, leksione, seminare, praktika artistike ose profesionale, ushtrime, laboratorë, forma të tjera të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor në javë.

Neni 85
Tarifat e studimeve

1. Në Universitetin e Arteve aplikohen këto lloje tarifash studimi:



- a) "Tarifa e konkurrimit", është vlera monetare që paguan studenti për llogari të UART, për të konkurruar në një nga programet e ofruara;
 - b) "Tarifa e regjistrimit", është vlera monetare që paguan studenti për llogari të UART, për t'u regjistruar në një program studimi pasi të jetë shpallur fitues në programin përkatës;
 - c) "Tarifa e shkollimit", është vlera monetare që paguan studenti për llogari të UART, për ndjekjen e një programi. Tarifat e shkollimit janë të diferencuara sipas cikleve apo dhe kategorive të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. "Tarifa e konkurrimit, Tarifa e regjistrimit, Tarifa e shkollimit", miratohen me vendim nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik të UART.

Neni 86

Programet e studimit në ciklin e parë

1. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda artistike profesionale, parime artistike të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh.
2. Programet e studimeve të ciklit të parë në Universitetin e Arteve realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike.
3. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, mbështetur në rregulloren e UART për këtë cikël studimi, në fund të studimeve diplomohen sipas përcaktimeve në rregulloren e studimeve me kohë të plotë Bachelor për secilin program studimi.
4. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare, "Bachelor" bashkëlidhur suplementi në fushën e arsimit të kryer, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut si dhe me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 87

Pranimi në ciklin e parë të studimeve, planifikimi i kuotave, hartimi i kriterëve dhe i rregulloreve të pranimit

1. Në Universitetin e Arteve, pranimi i kandidatëve bëhet me konkurs.
2. Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar (të ndjekë) studimet në një prej programeve të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve.
3. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së mesme të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Studimet në Universitetin e Arteve mund t'i ndjekin edhe studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.
5. Studimet në Universitetin e Arteve si program të dytë studimi, mund t'i ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.
6. Çdo departament duhet të përcaktojë, kuotat e pranimit, tarifën e pagesave, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
7. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit i përcillen nga Dekanati për miratim Senatit Akademik.
8. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit, bëhen publike në faqen zyrtare të UART si dhe në portalet e tjera sipas akteve nënligjore në fuqi. Një kopje



e tyre i përcillet institucionit përgjegjës për arsimin, sipas akteve nënligjore në fuqi.

Neni 88

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të parë

1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga UART, konsistojnë në:
 - a) emërtimi i programit të studimit sipas aktit të miratimit të hapjes së tij;
 - b) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
 - c) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
 - d) misioni, qëllimi dhe objektivat formues dhe kompetencat profesionale;
 - e) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
 - f) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
 - g) planin mësimor;
 - h) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
 - i) programin lëndor (*Syllabus-et*);
 - j) profilin e programit;
 - k) diplomën dhe suplementin.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit, mund të përcaktohen me propozim të departamenteve dhe më pas të miratohen nga Senati Akademik. Në asnjë rast elementet e programeve të studimit të ciklit të parë nuk duhet të bien ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 89


Lëshimi i diplomave dhe suplementi i diplomës

1. Universiteti i Arteve, lëshon diplomë “Bachelor” për ciklin e parë të studimeve sipas programeve të studimit në secilin prej Fakulteteve të UART.
2. Universiteti i Arteve pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
3. Diplomat shoqërohen me suplementin e diplomës.
4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UART, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
6. Çdo formë diplome, përpara se të lëshohet nga UART, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
7. Universiteti Arteve, nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, të miratuar sipas vendimit të Senatit Akademik.

Neni 90

Programet e studimit në ciklin e dytë

Në Universitetin e Arteve programet e studimit në ciklin e dytë organizohen në programe studimi “Master i Arteve”/“Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”.



Neni 91

Programi i studimit me kohë të plotë “Master i Arteve”

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në “Master i Arteve” i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara artistike-teorike dhe praktike në drejtimin përkatës në fushën e arteve.
2. Ky program realizohet me 120 kredite formimi referuar nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohëzgjatje normale jo më pak se dy vite akademike.
3. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare “Master i Arteve” bashkëlidhur me suplementin në fushën e arsimit të kryer, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve” përcaktohen nga njësia bazë (departamenti). Kriteret bëhen publike nga Dekani i Fakultetit, pasi miratohen nga Senati akademik.

Neni 92

Pranimi në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”, planifikimi i kuotave, hartimi i kriterëve dhe i rregulloreve të pranimit

1. Në Universitetin e Arteve, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve” bëhet me konkurs.
2. Në programet e studimit të ciklit të dytë kriter pranimi është njohja nga kandidati e një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në këtë statut, ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar (të ndjekë) studimet në një prej programeve me kohë të plotë “Master i Arteve” të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve.
4. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë “Bachelor” të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Studimet në Universitetin e Arteve mund t’i ndjekin edhe studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.
6. Studimet në Universitetin e Arteve si program të dytë studimi, mund t’i ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.
7. Çdo departament duhet të përcaktojë, kuotat e pranimit, tarifatat e pagesave, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
8. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit i përcillen nga Dekanati për miratim Senatit Akademik.
9. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit, bëhen publike në faqen zyrtare të UART si dhe në portalet e tjera sipas akteve nënligjore në fuqi. Një kopje e tyre i përcillet institucionit përgjegjës për arsimin, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 93

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”



1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master i Arteve”, të ofruara nga UART, konsistojnë në:
 - a) emërtimi i programit të studimit sipas aktit të miratimit të hapjes së tij;
 - b) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
 - c) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
 - d) misioni, qëllimi dhe objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
 - e) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
 - f) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
 - g) planin mësimor;
 - h) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
 - i) programin lëndor (*Syllabus-et*);
 - j) profilin e programit;
 - k) diplomën dhe suplementin.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit, mund të përcaktohen me propozim të departamenteve dhe më pas të miratohen nga Senati Akademik. Në asnjë rast elementet e programeve të studimit të ciklit të dytë nuk duhet të bien ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 94


Lëshimi i diplomave dhe suplementi i diplomës “Master i Arteve”

1. Universiteti i Arteve, lëshon diplomë “Master i Arteve” për ciklin e dytë të studimeve sipas programeve të studimit në secilin prej Fakulteteve të UART.
2. Universiteti i Arteve pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
3. Diplommat shoqërohen me suplementin e diplomës.
4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UART, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Çdo formë diplome, përpara se të lëshohet nga UART, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
7. Universiteti i Arteve, nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, të miratuar sipas vendimit të Senatit Akademik.

Neni 95

Programi i studimit me kohë të plotë “Master i Shkencave”

1. Programet e studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë në “Master i Shkencave” i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara shkencore-artistike-teorike dhe praktike në drejtimin përkatës në fushën e arteve.
2. Ky program realizohet me 120 kredite formimi referuar nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me kohëzgjatje normale jo më pak se dy vite akademike.
3. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë, lëshohet diplomë universitare “Master i Shkencave” bashkëlidhur me suplementin në fushën e arsimit të kryer, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë statut si dhe me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.



4. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Shkencave” përcaktohen nga njësia bazë (departamenti). Kriteret bëhen publike nga Dekani i Fakultetit, pasi miratohen nga Senati akademik.

Neni 96

Pranimi në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Shkencave”, planifikimi i kuotave, hartimi i kriterëve dhe i rregulloreve të pranimit

1. Në Universitetin e Arteve, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Shkencave” bëhet me konkurs.
2. Në programet e studimit të ciklit të dytë kriter pranimi është njohja nga kandidati e një prej 5 gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në këtë statut, ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar (të ndjekë) studimet në një prej programeve me kohë të plotë “Master i Shkencave” të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve.
4. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë “Bachelor” të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Studimet në Universitetin e Arteve mund t’i ndjekin edhe studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.
6. Studimet në Universitetin e Arteve si program të dytë studimi, mund ti ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.
7. Çdo departament duhet të përcaktojë, kuotat e pranimit, tarifën e pagesave, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
8. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit i përcillen nga Dekanati për miratim Senatit Akademik.
9. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit, bëhen publike në faqen zyrtare të UART si dhe në portalet e tjera sipas akteve nënligjore në fuqi. Një kopje e tyre i përcillet institucionit përgjegjës për arsimin, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 97

Elementët e programeve të studimeve të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Shkencave”

1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master i Shkencave”, të ofruara nga UART, konsistojnë në:
 - a) emërtimi i programit të studimit sipas aktit të miratimit të hapjes së tij;
 - b) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
 - c) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
 - d) misioni, qëllimi dhe objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
 - e) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
 - f) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
 - g) planin mësimor;
 - h) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
 - i) programin lëndor (*Syllabus*-et);



- j) profilin e programit;
 - k) diplomën dhe suplementin.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit, mund të përcaktohen me propozim të departamenteve dhe më pas të miratohen nga Senati Akademik. Në asnjë rast elementet e programeve të studimit të ciklit të dytë nuk duhet të bien ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 98

Lëshimi i diplomave dhe suplementi i diplomës në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”

1. Universiteti i Arteve, lëshon diplomë “Master i Shkencave” për ciklin e dytë të studimeve sipas programeve të studimit në secilin prej Fakulteteve të UART.
2. Universiteti i Arteve pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
3. Diplomat shoqërohen me suplementin e diplomës.
4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UART, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Çdo formë diplome, përpara se të lëshohet nga UART, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
7. Universiteti Arteve, nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, të miratuar sipas vendimit të Senatit Akademik.

Neni 99

Programi i studimit me kohë të plotë “Master Profesional”

1. Programet e studimeve “Master Profesional” u ofrojnë të diplomuarve me një diplomë të ciklit të parë “Bachelor” arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional, njohuri me karakter praktik profesional në drejtimin përkatës.
2. Programet e studimeve me kohë të plotë “Master profesional” realizohen me 120 kredite formimi referuar nivelit 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike.
3. Studentët në këtë program, mbështetur në kriteret e vendosura në rregulloren e fakultetit për notën mesatare, mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.
4. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional”, lëshohet diplomë universitare “Master Profesional” në fushën e arsimimit të kryer.
5. Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të pranojnë kandidatë që kanë fituar diplomë “Master Profesional” në studimet e ciklit të dytë për diplomën universitare “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” dhe të vendosin kriteret për njohjen/transferimin e krediteve të vlefshme të fituara në studimet e masterit që i përgjigjen programit të studimeve të ciklit të dytë.

Neni 100



**Pranimi në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master Profesional”,
planifikimi i kuotave, hartimi i kriterëve dhe i rregulloreve të pranimit**

1. Në Universitetin e Arteve, pranimi i kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master Profesional” bëhet me konkurs.
2. Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “Bachelor” dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në këtë statut, ka të drejtë të konkurrojë për t’u pranuar (të ndjekë) studimet në një prej programeve me kohë të plotë “Master Profesional” të ofruara nga fakultetet e Universitetit të Arteve.
3. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë “Bachelor” të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Studimet në Universitetin e Arteve mund t’i ndjekin edhe studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi.
5. Studimet në Universitetin e Arteve si program të dytë studimi, mund ti ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik.
6. Çdo departament duhet të përcaktojë, kuotat e pranimit, tarifën e pagesave, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë.
7. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me propozimin e tarifave përkatëse për këtë procedurë si dhe me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit i përcillen nga Dekanati për miratim Senatit Akademik.
8. Kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve të pranimit, bëhen publike në faqen zyrtare të UART si dhe në portalet e tjera sipas akteve nënligjore në fuqi. Një kopje e tyre i përcillet institucionit përgjegjës për arsimin, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 101

**Elementët e programeve të studimeve të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë
“Master Profesional”**

1. Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë “Master Profesional”, të ofruara nga UART, konsistojnë në:
 - a) emërtimi i programit të studimit sipas aktit të miratimit të hapjes së tij;
 - b) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
 - c) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
 - d) misioni, qëllimi dhe objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
 - e) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
 - f) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
 - g) planin mësimor;
 - h) kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;
 - i) programin lëndor (*Syllabus*-et);
 - j) profilin e programit;
 - k) diplomën dhe suplementin.
2. Elementë të tjerë të programeve të studimit, mund të përcaktohen me propozim të departamenteve dhe më pas të miratohen nga Senati Akademik. Në asnjë rast elementet e programeve të studimit të ciklit të dytë nuk duhet të bien ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.



Neni 102

Lëshimi i diplomave dhe suplementit të diplomës në “Master Profesional”

1. Universiteti i Arteve, lëshon diplomë “Master Profesional” për ciklin e dytë të studimeve sipas programeve të studimit në Fakultetin e FM të UART.
2. Universiteti i Arteve pajis studentët, që kanë përfunduar të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.
3. Diplomat shoqërohen me suplementin e diplomës.
4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai lëshohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) përshkruan në veçanti natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UART, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Përmbajtja, forma e diplomës dhe e suplementit të diplomës përcaktohen nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Çdo formë diplome, përpara se të lëshohet nga UART, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe regjistrin shtetëror të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
7. Universiteti i Arteve, nuk mund të lëshojë dublikatë diplome, por mund të lëshojë dokument të barasvlefshëm me diplomën në formën e vërtetimit, të miratuar sipas vendimit të Senatit Akademik.

Neni 103

Programet e studimit në ciklin e tretë

1. Programet e studimit në ciklin e tretë të studimeve mund të organizohen në programe studimi “Master Ekzekutiv”, programe specializuese afatgjata, si edhe në studimet e doktoratës.

Neni 104

Programet e studimit “Master ekzekutiv”

1. Programet e studimeve të ciklit të tretë në “Master ekzekutiv” i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Master i Shkencave”/”Master i Arteve” me arsim të një niveli të lartë shkencor dhe profesional, njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë të ngushtë, brenda një specialiteti.
2. Ky program realizohet me 60 ose 120 kredite.
3. Studimet në këtë program përmbyllen me punim diplome.
4. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të tretë, lëshohet diplomë universitare “Master ekzekutiv” në fushën e arsimimit të kryer.

Neni 105

Programet specializuese afatgjata

1. Programet e studimeve specializuese afatgjata janë programe të formimit profesional që ofrojnë njohuri për profesione të veçanta.
2. Ky program organizohet në jo më pak 120 kredite dhe zgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se dy vite akademike.
3. Studentët në këtë program, mbështetur në kriteret e vendosura në rregulloren e fakultetit, mund të diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.
4. Në përfundim të programeve të studimeve specializuese afatgjata lëshohet diplomë universitare specializimi me titullin në fushën përkatëse.



Neni 106
Studimet e doktoratës

1. Programet e studimeve të doktoratës janë programe të studimeve të ciklit të tretë, me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor, projektin artistik dhe veprimtarinë krijuese të pavarur në fushat e përcaktuara nga departamenti apo fakulteti.
2. Në studimet e doktoratës pranohen kandidatë që kanë fituar diplomë universitare “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve”, ose një diplomë të njëvlefshme me to, si dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga rregullorja e ciklit të tretë të studimeve të miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
3. Universiteti i Arteve, në bazë të rezultateve të arritura në studimet e organizuara artistike ose teorike, vendos kritere klasifikimi për kandidatët që kanë të drejtë të zhvillojnë projektin artistik ose të përgatitjes së tezës doktoale. Universiteti i Arteve përcakton standarde e kritere kualifikuese si dhe metoda për vlerësimin e nivelit artistik dhe atij teorik të përgjithshëm të kandidatëve. Kandidatët, që nuk arrijnë të përmbushin kriteret e vendosura, nuk klasifikohen për të vazhduar më tej studimet e doktoratës dhe pajisen me një dëshmi, në të cilën jepen modulet e zhvilluara së bashku me kreditet e grumbulluara dhe vlerësimin e tyre.
4. Në përputhje me parashikimet e këtij statuti, Universiteti i Arteve harton rregulloren e studimeve të doktoratës, në të cilën gjejnë rregullim edhe kriteret për vlerësimin vjetor të ecurisë së kandidatëve dhe për vazhdimin e punës në zhvillimin e projektit artistik-kërkimor.
5. Në përfundim të programit të studimeve të doktoratës lëshohet diplomë për gradën shkencore “Doktor” (Dr.).

Neni 107
Pranimi në ciklin e tretë të studimeve

1. Çdo departament duhet të përcaktojë, rregulloret e studimeve për ciklin e tretë, kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse një program studimi ofrohet nga 2 apo më shumë departamente, kriteret përcaktohen nga departamentet që e ofrojnë programin në bashkëpunim me njëri-tjetrin.
2. Çdo njësi kryesore ka për detyrë të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga departamentet, për të gjitha programet e studimit që ofron. Si rregull, këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja. Kriteret i përcillen rektoratit, të cilat miratohen në Senatin Akademik dhe më pas i përcillen MASR.
3. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e tretë të studimeve kandidatët:
 - i. që kanë përfunduar studimet e larta në fushën e kërkuar dhe që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë, një diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi;
 - ii. që kanë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, në përputhje me kriteret e shpallura;
 - iii. që kanë dëshmi zotërimi të një nga pesë gjuhët e huaja të vlerësuara sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - iv. që kanë dy rekomandime nga persona që gëzojnë titull shkencor, të cilët njohin aftësitë akademike, artistike dhe profesionale të kandidatit;
 - v. që zbatojnë standardet shkencore dhe etike;
 - vi. si dhe kritere të tjera të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Rregulla të mëtejshme për pranimin e studentëve në ciklin e tretë të studimeve përcaktohen



në rregulloret e njësisive kryesore si dhe në rregulloren e studimeve të ciklit të tretë të miratuar nga Senati Akademik.

Neni 108

Programet e përbashkëta të studimit

1. Në marrëveshje me universitetet të tjera, njësitë kryesore të Universitetit të Arteve, ofrojnë programe të përbashkëta studimi.
2. Për këtë qëllim njësisia e UART që do të bashkëpunojë me njësinë kryesore të një universiteti tjetër, ka të drejtë të kryejë bisedime me palën tjetër për hartimin e marrëveshjes.
3. Propozimi mund të niset nga fakultetet e Universitetit të Arteve, ose edhe nga njësitë kryesore të universitetit tjetër. Në çdo rast njoftohet Rektori për fillimin e këtij procesi.
4. Marrëveshja duhet të trajtojë:
 - a) emërtimi i programit të studimit;
 - b) ciklin e studimeve ku do të ofrohet program i përbashkët i studimit;
 - c) mënyrën e ekuivalentimit të krediteve;
 - d) shkëmbimin e personelit akademik;
 - e) shkëmbimin e studentëve;
 - f) vendin e realizimit të programit të studimit;
 - g) mënyrën e vlerësimit të studentëve;
 - h) mënyrën e diplomimit;
 - i) gjuhën në të cilën do të ofrohet programi i studimit;
 - j) formën e diplomës dhe të suplementit;
 - k) përballimin e kostove financiare;
 - l) kohëzgjatja e marrëveshjes dypalëshe;
 - m) elemente të tjera të nevojshme.
5. Me përfundimin e bisedimeve, projekt marrëveshja i paraqitet për miratim Senatit Akademik, dhe më pas ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Neni 109

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

1. Departamentet e fakulteteve të Universitetit të Arteve, kanë të drejtë që në marrëveshje me ministritë e linjës përgjegjëse sipas kuadrit ligjor, të ofrojnë programet e studimeve të formimit të vazhduar.
2. Në këtë rast marrëveshja, në përputhje me parashikimet ligjore, duhet të përcaktojë:
 - a) strukturën e programit;
 - b) kohëzgjatjen;
 - c) kreditet;
 - d) personelin mësimdhënës dhe aktivizimin e zyrtarëve të institucionit në mësimdhënie;
 - e) llojin e dëshmisë që lëshohet në përfundim të studimeve.
3. Në rast se departamentet do të ofrojnë kurse përgatitore për programet e studimeve, atëherë për përcaktimin e programit dhe miratimin e tij, zbatohet, me ndryshimet përkatëse procedura për hartimin e programeve për ciklet normale të studimit e përcaktuar në këtë statut.

Neni 110

Programet e studimit në fushën e mësuesisë

1. Fakultetet e Universitetit të Arteve ofrojnë programe në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, në fushën e mësuesisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.



2. Programet në këtë fushë janë hartuar/hartohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë Statut.

Neni 111

Elementet e programeve të lëndës

1. Projekt-programi hartohet në përputhje me kërkesat e këtij statuti dhe sipas formatit të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Projekt-programet e përgatitura nga departamentet, organizohen në module e lëndë.
3. Në hartimin e programeve, departamentet duhet të kenë parasysh shmangien dhe përsëritjen e moduleve të njëjta në ciklet e ndryshme të studimit.
4. Në çdo rast literatura dhe materialet e ndryshme që do të përdoren në secilin program studimi dhe në secilën lëndë duhet të miratohen nga departamentet përkatëse, në përputhje me rregulloren e njësisë kryesore.

Neni 112

Hartimi i programeve mësimore nga departamentet

Sipas afateve ligjore programet mësimore hartohen, riorganizohen apo ndryshohen nga departamentet në përputhje me përcaktimet e këtij Statuti, me rregulloren e Fakultetit ku ato bëjnë pjesë si dhe mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 113


Miratimi i programeve mësimore nga Senati Akademik

1. Me marrjen e propozimit për hapjen ose riorganizimin e programit të studimit, Rektori ia dërgon për shqyrtim, projekt-programin, Sektorit të Kurrikulës, ndjekjes së studentëve dhe NJSBC i cili, brenda 10 ditëve, harton një raport për Senatin Akademik ku shprehet në lidhje me miratimin, kthimin për plotësim apo mosmiratimin e projekt-programit.
2. Senati Akademik, del me vendimin përkatës për miratimin, kthimin për plotësim, ose mosmiratimin e projekt-programit.
3. Në rast të kthimit për plotësim, Senati Akademik i cakton një afat departamentit përkatës për kryerjen e veprimeve përkatëse. Kërkesat e Senatit Akademik janë të detyrueshme për departamentin në rishqyrtimin e projekt-programit.
4. Me miratimin e projekt-programit, Rektori:
 - a) njofton ministrinë në rast se projekt-programi sjell ndryshime deri në masën 20 përqind të një programi studimi ekzistues;
 - b) njofton AKKF në rast të një projekt-programi për të cilin kërkohet mbështetje financiare nga buxheti i shtetit;
 - c) kërkon miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin për projekt-programin që ndryshon më shumë se 20 përqind të një programi studimi ekzistues, ose është një program studimi i ri.

Neni 114

Transferimet

1. Sipas kuotave të miratuara, UART ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studentëve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda programeve që ofron UART apo të institucioneve të tjera të arsimit të lartë.
2. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në UART, i takon komisionit përkatës të departamentit.



pjesë e fakultetit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e tij. Vendimin përfundimtar për kërkesën për transferim e merr Dekani i atij fakulteti ku ka aplikuar kandidati.

3. Si rregull, në këtë procedurë pranohen kandidatët me rezultatet më të larta.
4. Universiteti i Arteve mund të njohë kreditet e përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i Arteve”/“Master i shkencave”. Procesi i njohjes përcaktohet në rregulloren e Universitetit të Arteve.
5. Kritere të tjera më të detajuara mbi përafrimin apo përputhshmërinë e emërimit të programit të studimit/të syllabusve të lëndëve si dhe për njohjen e krediteve, përcaktohen në rregulloret mësimore të cikleve të studimit të Universitetit të Arteve.

Neni 115

Vlerësimi moral për studentët

1. Studentët që në përfundim të studimeve të plota të çdo cikli kanë të gjitha notat dhjeta, fitojnë “Medalje të Artë” me certifikatën përkatëse. Ata që kanë jo më pak se 80% të notave dhjeta e pjesën tjetër nënta, fitojnë Certifikatën “Student i Shkëlqyer”.
2. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni në çdo fakultet. Për studentët që fitojnë “Medalje të Artë” ose Certifikatën “Student i Shkëlqyer”, ceremonia organizohet në shkallë universiteti dhe dorëzimi i diplomave bëhet personalisht nga Rektori në prani të përfaqësuesve të Senatit, të personelit akademik, të administratës dhe të studentëve.

KREU VIII

KËRKIMI ARTISTIK SHKENCOR

Neni 116


Veprimtaritë e kërkimit artistik shkencor

1. Universiteti i Arteve kryen veprimtari artistike kërkimore dhe shkencore, studime, veprimtari krijuese artistike, ekspertizë shkencore, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin kulturor të vendit.
2. Kërkimi shkencor realizohet në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së UART, fushat parësore të identifikuar nga AKKSHI si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Departamentet në fillim të çdo viti akademik përcaktojnë fushat, drejtimet, vëllimin e punës dhe afatet e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore, me përjashtim të rasteve kur kanë miratuar plane afatmesme dhe afatgjata për kërkimin artistik-shkencor.
4. Njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UART nxisin realizimin e tyre nga personeli akademik.
5. Veprimtaria artistike-kërkimore-shkencore, mund të zhvillohet në nivel kombëtar ose ndërkombëtar nëpërmjet marrëdhënie të bashkëpunimit, programeve dhe veprimtarive të përbashkëta, në bazë të marrëveshjeve paraprake të miratuara nga Senati Akademik i UART ose të miratuara nga Rektorati.

Neni 117

Subjektet që kryejnë kërkim artistik shkencor

- Të drejtën për të realizuar veprimtari artistike-kërkimore-shkencore si dhe krijuese e kanë:
- a. Personeli akademik;
 - b. Njësia bazë;
 - c. Studentët.



Neni 118

Realizimi i veprimtarisë artistike -kërkimore-shkencore

1. Personeli akademik mund të gjenerojë (hartojë, aplikojë, zbatojë) projekte mësimore artistike-kërkimore-shkencore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësisë bazë ku bën pjesë dhe t'i menaxhojë ato sipas miratimit të Administratorit të UART, në përputhje me Statutin dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Realizimi i veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore, në çdo rast mbështet në Rregulloren e Njesisë Kryesore dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 119

Financimi i kërkimit artistik/shkencor

1. Personeli akademik, njësia bazë apo studentët e UART kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare për realizimin e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore dhe krijuese.
2. Të ardhurat që vijnë nga kjo veprimtari përbëjnë një zë të veçantë në buxhetin e UART.
3. Në menaxhimin e këtyre të ardhurave në përputhje me parashikimet e veprimtarisë artistike-kërkimore-shkencore, personeli akademik, njësia bazë apo studentët ndihmohen nga administratori UART.
4. Në buxhetin që përcaktohet nga Administratori i UART për çdo njësi kryesore sipas planifikimit të argumentuar duhet të përcaktohet dhe një fond që të mbështesë veprimtarinë mësimore-artistike-shkencore.

Neni 120

Kërkimi artisti-shkencor me ose për të tretët

1. UART nëpërmjet njësive përbërëse u ofron të tretëve ose pranon oferta për kërkim artistik-shkencor, ekspertizë artistike-shkencore, shërbime të tjera, ose i realizon ato në bashkëpunim me të tretë.
2. Të ardhurat e krijuara nga ky shërbim administrohen nga UART në favor të njesisë përkatëse që e ofron këtë shërbim në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**KREU IX
STUDENTËT**

Neni 121

Studentët

1. Student është çdo person fizik shqiptar ose i huaj i regjistruar në një nga programet e studimit të ofruara nga UART, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe ky Statut.
2. Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një nga njësitë kryesore të UART. Statusi humbet kur studentin merr diplomën ose certifikatën përkatëse, apo çregjistrohet nga UART.
3. Çdo student është i detyruar të regjistrohet dhe të ndjekë vetëm një program studimi. Bëjnë përjashtim nxënësit dhe studentët e shkëlqyer të cilët mund të ndjekin deri në dy programe studimi në të njëjtën kohë.

Neni 122



Të dhënat e studentëve

Të dhënat e studentëve ruhen dhe përpunohen nga UART dhe njësitë kryesore në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 123

Të drejtat e studentëve

Studentët gjatë ndjekjes së studimeve në UART kanë këto të drejta:

1. Të përfaqësohen në organet e UART, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.
2. Të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UART, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore.
3. Të ndjekin leksione, seminare dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore, të organizuara në përputhje me programin e studimit që ata ndjekin.
4. Të përdorin infrastrukturën e UART dhe shërbime të tjera që ofrohen për ta.
5. Të shprehin opinionin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të institucionit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë.
6. Të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe shpërblime të tjera të veçanta që administrohen nga UART.
7. Të pajisen me diplomë, ose certifikatë, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme në përfundim të programit të studimit që ka ndjekur.
8. Të marrin pjesë në mënyrë të programuar apo të organizuar në programe studimi jashtë njësisë kryesore ku studiojnë, të zhvillojnë një apo shumë semestra jashtë UART, si dhe t'u njihen kreditet dhe lëndët e zhvilluara.
9. Të zhvillojnë praktika mësimore, në institucione që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UART apo njësitë kryesore.
10. Të pajisen me Kartën e Studentit dhe të përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.
11. Të organizohen në organizata jofitimprurëse, brenda UART duke iu përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
12. Të sigurohen nga institucioni i arsimit të lartë, në një ndër shoqëritë e sigurimit, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar të studimeve, për riskun e ndërprerjes së veprimtarisë apo risqe të tjera, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin dhe Ministrit të Financave.

Neni 124

Detyrimet e studentëve

Studentët kanë këto detyrime:

1. Të zbatojnë Statutin dhe Rregulloren në fuqi të UART dhe të njësisë kryesore, ku po ndjekin programin e studimit.
2. Të respektojnë Kodin e Etikës të UART.
3. Të sillen me korrektësi dhe të respektojnë të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe të studentëve të tjerë.
4. Të përmbushin në kohën dhe afatet e caktuara, si dhe me cilësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga programi i studimit dhe të marrin pjesë në gjithë veprimtaritë akademike që realizohen nga njësitë kryesore.
5. Të paguajnë tarifatat dhe detyrimet financiare për shërbimet e ofruara nga njësitë kryesore dhe



UART.

Neni 125
Pezullimi i studimeve

1. Çdo student ka të drejtë të pezullojë studimet e tij dhe t'i rifillojë ato në çdo kohë. Koha e pezullimit nuk mund të jetë me e gjatë se dyfishi i kohës së kryerjes së studimeve për atë cikël studimi. Pas kësaj, studenti duhet të nisë nga e para regjistrimin në programin e nisur, sipas rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Me pezullimin e studimeve, studentit i pezullohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me programin e studimit që ai ka ndjekur. Këto të drejta dhe detyrime i kthehen me rifillimin e studimeve.
3. Procedurat e pezullimit dhe rifillimit të studimeve përcaktohen në rregulloren e UART dhe të njësisë kryesore.

Neni 126
Përfaqësuesit e Studentëve

Studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësuesit e tyre në:

- a) Senatin Akademik,
- b) Këshillin e Etikës,
- c) Komisionet e përhershme të lejuara me statut,
- d) Këshillat e Studentëve.

Neni 127
Këshillat e studentëve

1. Këshillat e studentëve janë organizime të pavarura të studentëve të UART, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit.
2. Këshillat e studentëve nuk zhvillojnë veprimtari politike, ekonomike apo veprimtari të tjera që nuk janë në përputhje me Statutin e UART dhe Kodin e Etikës.
3. Këshillat e studentëve kanë të drejtë të organizohen në nivel të njësisë kryesore me jo më pak se tre përfaqësues dhe në nivel të UART me jo më pak se nëntë përfaqësues.
4. Në nivel institucional zgjidhen kryetari dhe nënkryetari si dhe sekretari i Këshillit Studentor.

Neni 128
Veprimtaria e Këshillave të Studentëve

1. Këshillat e studentëve e mbështesin veprimtarinë e tyre në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në këtë Statut si dhe në aktet për organizimin dhe funksionimin Këshillave studentore.
2. Këshilli i Studentëve ndër të tjera propozon pranë drejtuesit të njësisë kryesore, Kujdestarin e Studentëve. Kujdestari i Studentëve caktohet njëri nga pedagogët e fakultetit i zgjedhur nga Këshilli i Studentëve dhe i miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Kujdestari i Studentëve ka për mision përçimin e çdo problemi apo shqetësimi të çdo studenti tek strukturat e njësisë bazë. Nëse nuk arrin të zgjidhi problemin apo shqetësimin e ngritur i drejtohet Rektoratit të UART.
3. Këshilli i Studentëve të UART harton dhe miraton statutin për funksionimin e tij. Këshillat e studentëve të njësisë kryesore hartojnë dhe miratojnë rregulloret për funksionimin e tyre në përputhje me statutin e Këshillit të Studentëve të UART.

Neni 129



Funksionet e Këshillave të Studentëve

Këshillat e Studentëve të UART kanë të drejtë:

1. Të promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe të koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet e UART dhe njësive kryesore.
2. Të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve të UART, rregulloret për veprimtaritë mësimore, si dhe të drejtën për të studiuar.
3. Të japin opinionet e tyre për cilësinë e shërbimeve të ofruara nga njësitë kryesore dhe/ ose njësitë bazë.
4. Të marrin pjesë në përcaktimin dhe të bëjnë propozime në lidhje me tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose në ndarjen e burimeve financiare.
5. Të organizojnë së bashku me njësitë kryesore ose vetëm veprimtari të ndryshme artistike, shkencore, shoqërore, kulturore, sportive etj.

Neni 130

Zgjedhja e Këshillave të Studentëve

1. Këshillat e studentëve kanë mandat 2-vjeçar dhe anëtarët e tyre zgjidhen nga votat e të gjithë studentëve të njësive kryesore të UART.
2. Rregullat në lidhje me procesin e votimit përcaktohen në rregulloren përkatëse.

Neni 131

Ngritja e Këshillave të Studentëve

1. Në momentin e nisjes së procesit të ngritjes së strukturave për Këshillat e Studentëve duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese, përkatësisht Rektori dhe Administratori i UART, nëse janë në nivel të UART, ose Dekanin, nëse janë në nivel njësie kryesore.
2. Pas zhvillimit të zgjedhjeve dhe nxjerrjes së rezultatit, si dhe krijimit të Këshillave të Studentëve duhet të vihen në dijeni autoritetet drejtuese si më sipër.

Neni 132

Organizata të tjera

Studentët kanë të drejtë që të organizohen edhe në forma të tjera të njohura nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe të realizojnë vetë ose në bashkëpunim me strukturat e Universitetit të Arteve dhe njësive bazë aktivitete trajnimi, mësimore dhe/ose artistike e kërkimore shkencore.

Neni 133

Financimi

1. Veprimtaria e Këshillit të Studentëve të UART financohet dhe mbështetet nga buxheti i UART mbi bazën e parashikimeve në buxhet.
2. Këshillat e Studentëve kanë të drejtë të krijojnë dhe fonde të tjera të ligjshme të bazuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 134

Disiplina

1. Për shkelje të rregullave të Etikës dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe në këtë statut apo akte të tjera të Universitetit të



- Arteve dhe njësisve të tjera të saj, studentët mbajnë përgjegjësi disiplinore.
- Llojet e shkëlqeve disiplinore, konstatimi dhe procedimi i tyre rregullohen në Rregulloren e Universitetit të Arteve dhe në Rregulloret e njësisve kryesore të UART.

KREU X SIGURIMI I CILËSISË

Neni 135

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UART

- Sigurimi i cilësisë në UART realizohet nëpërmjet sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit jashtëm të cilësisë.
- UART është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional, vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit artistik/shkencor, ndjekjen e vazhdueshme të ecurisë dhe vlerësimit të studentëve në veprimtarinë e tyre artistike-mësimore, shtrirjen e sistemit të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative dhe njësisve kryesore dhe bazë të UART.
- Sigurimi i brendshëm i cilësisë ka si qëllim:
 - të rrisë cilësinë e drejtimit të UART, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave afatshkurtra dhe afatgjata;
 - të rrisë cilësinë e formimit të studentëve duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies;
 - të nxisë studentët për të qenë aktiv në dhënien e opinioneve mbi aktualitetin e përditshëm gjatë kohës që janë pjesë përbërëse e UART;
 - të zbatojë metoda të sakta në sigurimin e cilësisë në një mënyrë të lartë profesionale.
- Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UART i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni.

Neni 136

Parimet e funksionimit të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm i Cilësisë (NJSBC) funksionon pranë Sektorit të Kurrikulës, ndjekjes së studentëve dhe NJSBC, dhe është përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të UART dhe të programeve të studimit që ofron. NJSBC është përgjegjëse për koordinimin e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- NJSBC ka për detyrë të kryejë vlerësimin dhe raportimin periodik sipas fushave të veprimit të sigurimit të cilësisë të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me standardet cilësisë. NJSBC ka akses të plotë në grumbullimin e të dhënave drejtpërdrejtë në njësitë kryesore të UART. Rezultatet apo edhe analizat e nxjerra, NJSBC i raporton Zëvendës rektorit për anën mësimore.
- Funksionet e NJSBC janë në përputhje me kërkesat kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë. NJSBC krijon bazën dokumentare si udhëzime, pyetësorë vlerësimi për stafin akademik, stafin administrativ dhe studentët, mbledh, administron dhe përpunon të dhëna apo dhe informacione bazuar në procese dhe rezultate, evidenton çështje dhe jep rekomandimet përkatëse.

Neni 137



Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

1. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Në përbërje të KPSBC-së zgjidhet nga një përfaqësues nga secili fakultet i UART, një përfaqësues nga Rektorati që është specialisti i NSBC dhe një përfaqësues nga studentët. Vetëm në rastet kur institucioni i nënshtrohet akreditimit institucional periodik dhe akreditimit për herë të parë apo periodik të programeve të studimit që ofron UART, kur është e nevojshme, thirret një ekspert i jashtëm.
2. Kanë të drejtë të kandidojë për anëtarë të KPSBC pjesëtarë të personelit akademik minimalisht me gradën shkencore “Doktor”, me përvojë në mësimdhënie mbi 5 vjet.
3. Anëtari i Komisionit, pjesë e studentëve të UART duhet të jetë me mesatare të përgjithshme mbi 9 (nëntë).
4. Anëtari ekspert i jashtëm mund të jetë shtetas shqiptar ose i huaj, që i përket kategorisë “Profesor” me përvojë në mësimdhënie mbi 5 vjet. Anëtarët e KPSBC zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 138

Funksionet e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

1. KPSBC planifikon të gjitha aktivitetet lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Konkretisht:
 - a) bën mbledhjen e të dhënave sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programet e studimit;
 - b) organizon vlerësimin e vazhdueshëm periodik të sigurimit të cilësisë;
 - c) krijon një sistem dokumentacioni për sigurimin e cilësisë duke përditësuar procedurat e ndryshme në funksion të sigurimit të cilësisë, formularët tip, etj.;
 - d) përmirëson metodologjinë e punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave;
 - e) bën vlerësime për stafin akademik duke filluar me pyetësorët e studentëve;
 - f) merr në konsideratë vlerësimet e performancës së lektorëve mbi mësimdhënien, kërkimin artistik-shkencor, mbështetjen administrative në njësinë përkatëse;
 - g) bën përpunimin e pyetësorëve;
 - h) nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin për zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet plan veprimeve të detajuara dhe të argumentuara;
 - i) bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm në nivel institucional, nivel njësie kryesore dhe njësie bazë;
 - j) merr pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm (grupe *ad hoc*) që ngrihen nga titullari i institucionit, për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;
 - k) ruan dhe përmirëson njohuritë teknike dhe profesionale duke marrë pjesë në trajnime të ndryshme që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë;
 - l) bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë për procesin e vlerësimit dhe akreditimit;
 - m) bashkëpunon me njësitë apo komisionet e sigurimit të cilësisë në institucionet e tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën dhe për të nxitur bashkëpunimet ndër-institucionale;
 - n) ruan lidhjet dhe bashkëpunon me ALUMNI për përmirësimin e programeve të studimit dhe përmirësimin e mënyrës së mësimdhënies dhe mësim nxënies. Ky bashkëpunim mund të sjellë edhe realizimin e projekteve apo edhe të aktiviteteve të ndryshme në funksion të rritjes së nivelit të aktiviteteve socio-kulturore të studentëve aktualë të UART;
 - o) etj.



KREU XI FINANCIMI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Neni 139

Parimet e financimit të Universitetit

1. UART financohet nga Buxheti i Shtetit, mbështetur në këto parime:
 - a) konkurrenca e lirë midis institucioneve që gëzojnë të njëjtin status;
 - b) mundësitë e barabarta për institucionet e arsimit të lartë, në varësi të statusit që ato kanë;
 - c) mbështetja e interesave prioritare e strategjike të vendit;
 - d) shpërndarja e fondeve, mbështetur në treguesit e cilësisë së institucioneve për mësimdhënien, kërkimin artistik-shkencor, veprimtaritë krijuese dhe inovacionin e zhvillimin.

Neni 140

Autonomia financiare

1. UART funksionon sipas parimit të autonomisë financiare.
2. UART harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit. Secili fakultet brenda datës 15 korrik, paraqet në Rektorat projektbuxhetin e tij për vitin pasardhës.
3. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga Universiteti i Arteve përdoren prej tij dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës.
4. Përdorimi i fondeve publike nga Buxheti i Shtetit bëhet në përputhje me kushtet dhe qëllimet e grantit të akorduar.

Neni 141

Burimet e financimit të UART

1. UART ka buxhetin e tij që krijohet nga burimet e përcaktuara më poshtë dhe që realizohet në përputhje me rregulla ligjore të detyrueshme përgjithësisht në entet publike duke ruajtur autonominë në përdorimin e të ardhurave.
2. UART financohet nga:
 - a) buxheti i Shtetit;
 - b) pagesat e studentëve për arsimim;
 - c) të ardhurat për shërbimet e kryera;
 - d) të ardhurat nga qiradhënia;
 - e) të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
 - f) donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
 - g) veprimtari artistike-kërkimore-shkencore;
 - h) projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare;
 - i) të ardhura nga pjesëmarrja në shoqëri tregtare ose organizata jofitimprurëse të krijuara ose në të cilat merr pjesë UART për të mbështetur veprimtari sipas kushteve të legjislacionit në fuqi.
3. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë artistike-kërkimore-shkencore, konsulencat, çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë Universiteti i Arteve, njësitë bazë dhe njësitë kryesore të tij, administrohen dhe përdoren sipas një rregulloreje të veçantë, të miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit.
4. I njëjti rregull administrimi dhe përdorimi vlen edhe për sa i përket administrimit të fondeve që vijnë si rezultat i projekteve apo donacioneve, të cilat depozitohen në llogari rrjedhëse të UART dhe përdoren në përputhje edhe me marrëveshjen e cila parashikon akordimin e tyre.



Neni 142

Shoqëritë tregtare të UART

1. Universiteti i Arteve me qëllim përdorimin efikas të resurseve, rezultateve dhe njohurive të kërkimit artistik/shkencor, ka të drejtë që të krijojë shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.
2. Shoqëritë tregtare që krijohen për këtë qëllim përdoren për realizimin e një aktiviteti biznesi me karakter inovativ, mbështetur në rezultatet e kërkimit artistik/shkencor të zhvilluar në kuadër të programeve universitare.
3. Krijimi i këtyre shoqërive tregtare propozohet nga Rektorati dhe pas miratimit në Senat, bazuar në plan-biznesin e paraqitur nga Administratori i Institucionit, miratohen në Bordin e Administrimit.
4. Bordi i Administrimit shqyrton dhe vendos në lidhje me formën e shoqërisë tregtare, vlerën dhe formën e kapitalit që do të përdoret për krijimin e saj, mënyrën e administrimit, strukturën e saj, mënyrën e raportimit, etj.
5. Senati Akademik shqyrton dhe vendos në lidhje me fushën e veprimtarisë, kalimin e të drejtave të përdorimit dhe gëzimit të patentave, njohurive, shpikjeve etj., të cilat do të përdoren nga shoqëria tregtare.
6. Këto shoqëri tregtare mund të krijohen nga Universiteti i Arteve në mënyrë ekskluzive ose në bashkëpunim me persona juridikë të tjerë. Në këtë rast nga Bordi i Administrimit miratohet edhe marrëveshja për mënyrën e ndarjes së kuotave/aksioneve që do të kenë palët në këtë shoqëri. Në çdo rast, Universiteti duhet të zotërojë më shumë se gjysmën e kapitalit.
7. Statuti i shoqërisë miratohet paraprakisht nga Rektorati, Senati dhe miratohet përfundimisht nga Bordi i Administrimit.

Neni 143

Organizatat jofitimprurëse të UART

1. Në Universitetin e Arteve, me qëllim thellimin e kërkimit artistik/shkencor mbështetjen dhe zhvillimin e vlerave të artit, shkencës dhe arsimit, pjesëmarrjes në projekte dhe grante konkurruese, edukimit fizik dhe shpirtëror si dhe për çdo drejtim tjetër në të mirë të studentëve, mund të krijohen Organizata Jofitimprurëse në formën e shoqatave, fondacioneve apo qendrave.
2. Veprimtaria e tyre do të rregullohet në bazë të legjislacionit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe ligjit për Organizatat Jofitimprurëse.
3. Krijimi i Organizatave Jofitimprurëse dhe fusha e veprimtarisë së tyre propozohet nga njësi kryesore dhe pas miratimit në Rektorat, kalon për miratim në Senatin Akademik dhe në Bordin e Administrimit.

Neni 144

Përfitimi i financimit të UART

1. UART përfiton fonde nga Buxheti i Shtetit, të cilat shpërndahen në formë granti, sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) granti i politikave të zhvillimit;
 - b) granti i mësimdhënies;
 - c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.
2. Pjesa e papërdorur e grantit të financuar mbartet në vitin pasardhës.
3. Financimi i Universitetit të Arteve, mbështetur në modelin e financimit të buxhetit për

arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe zbatimi i skemës së financimit, kryhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për arsimin.

Neni 145

Pronat e Universitetit të Arteve

1. Bordi i Administrimit të UART administron pronat e paluajtshme në të cilat UART ushtron veprimtarinë.
2. Bordi i Administrimit të UART ruan dhe mirëmban pronat në administrim të UART dhe nuk mund të ndryshojë destinacionin e tyre.
3. Bordi i Administrimit të UART mund të zhvillojnë pronat me miratim paraprak të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të Ministrit përgjegjës për Arsimin.

Neni 146

Shërbimet

1. Shërbimet që mund të realizohen nga UART do të kryhen në përputhje me kushtet dhe modalitetet e përcaktuara në kontratën që do të lidhet midis UART dhe palëve të interesuara.
2. Tarifat e shërbimeve miratohen nga Bordi i Administrimit, me propozim të Administratorit të UART, sipas kërkesave të njëjësive kryesore dhe/ose atyre bazë.
3. Format e shërbimeve, projektimi dhe realizimi i tyre përcaktohen në “Rregulloren e UART”.

Neni 147

Raportimi

UART paraqet për çdo vit akademik pranë ministrisë përgjegjëse, raportin vjetor për veprimtarinë akademike dhe financiare sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sipas afateve që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

KREU XII

NDRYSHIMI I STATUTIT

Neni 148

Procedura e ndryshimit të statutit

1. Të drejtën e nismës për propozimin e ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve e kanë:
 - a) jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të Senatit Akademik,
 - b) jo më pak se 3 (tre) anëtarë të Bordit të Administrimit,
 - c) Rektori,
 - d) Asambleja e Personelit Akademik të çdo fakulteti të Universitetit të Arteve.
2. Propozimi duhet të shoqërohet me një relacion në të cilin të shpjegohen, qëllimi i ndryshimeve, përparësitë që ato sjellin, kostot financiare, nëse ka, si edhe çdo e dhënë tjetër që i shërben procesit të ndryshimeve në Statut.
3. Propozimi i paraqitet rektoratit, i cili ia kalon për konsultim të gjithave njëjësive bazë të Universitetit të Arteve. Ky proces konsultimi nuk mund të jetë më pak se 30 ditë.
4. Me përfundimin e procedurës së përcaktuar në pikën 3, rektori propozimin fillestar, relacionin përkatës dhe propozimet e sjella nga njësitë bazë ia përcjell për vendimmarrje Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, të cilët vendosin sipas kompetencave të përcaktuara në ligj.



5. Në rast se Senati Akademik kërkon të bëjë ndryshime në tekstin e miratuar nga Bordi i Administrimit, ia përcjell përsëri atij me ndryshimet përkatëse.
6. Në rast se ka mosmarrëveshje midis Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, atëherë ngrihet një grup pune i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, 2 (dy) nga secili organ, dhe 1 (një) i zgjedhur nga Rektori. Ky grup pune ndërmerr hartimin e një teksti të përbashkët.

KREU XIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 149

Hartimi i akteve të reja

Brenda 12 muajve nga miratimi i këtij Statuti, organet përkatëse hartojnë dhe miratojnë rregulloren e Universitetit të Arteve dhe rregulloret e organeve drejtuese dhe të njësive kryesore, Kodin e Etikës dhe akte të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij statuti.

Neni 150

Riorganizimi

Brenda 12 muajve nga miratimi i këtij Statuti, njësitë e Universitetit të Arteve, aty ku është nevoja riorganizohen në përputhje me kërkesat e këtij statuti.



Lidhja 1
Stema e Universitetit të Arteve.



ORGANIGRAMA- UNIVERSITETI I ARTEVE

